

PERCEPTIMET E STAFIT SHKOLLOR DHE PËRFAQËSUESVE TË KOMUNITETIT NGA SHKUPI, KUMANOVA, TETOVA DHE GOSTIVARI PËR RADIKALIZMIN QË ÇON NË EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

STUDIM BAZË

SHKUP, JANAR 2019

PERCEPTIMET E STAFIT SHKOLLOR DHE PËRFAQËSUESVE TË
KOMUNITETIT NGA SHKUPI, KUMANOVA, TETOVA DHE GOSTIVARI
PËR RADIKALIZMIN QË ÇON NË EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM
STUDIM BAZË

PERCEPTIMET E STAFIT SHKOLLOR DHE PËRFAQËSUESVE TË KOMUNITETIT NGA SHKUPI, KUMANOVA, TETOVA DHE GOSTIVARI PËR RADIKALIZMIN QË ÇON NË EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

STUDIM BAZË

Autorë

Dr. Filip Stojkovski

Në bashkëpunim me:

Mr. Ivan Stefanovski, kandidat për doktor të shkencave

Mr. Kristian Aleksovski

Redaktuar nga

Dr. Marija Risteska

Mbledhja e të dhënave:

Astrit Rexhepi

Besir Ramadani

Bojana Aleksova

Emir Shkrijelj

Fikreta Salju

Gabriella Boshkov

Miranda Horvati

Radmilla Serafimoska

Radovan Spiridonov

Zehra Saiti

Ky Studim bazë u zhvillua në kuadër të Projektit: **“Eduko për të parandaluar - përforcimi i stafit shkollor dhe prindërve për ndërtimin e rezistencës tek të rinjtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”**, të zbatuar nga Qendra për Hulimtim dhe Krijim të Politikave - QHKP dhe Qendra për Zhvillimin e Arsimit - CED në bashkëpunim me konceptin civil NEXUS. Publikimi është përgatitur me mbështetjen e Qendrës për përsosmëri Hedaja për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si pjesë e Programit global STRIVE, nëpërmjet instrumentit i cili kontribuon për stabilitetin dhe paqen (IcSP) të Bashkimit Evropian.

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë Studim bazë i pasqyrojnë mendimet dhe qëndrimet e autorëve të këtij publikimi dhe nuk i paraqesin mendimet e Bashkimit Evropian apo organizatave të tjera për mbështetje.

PËRMBAJTJA

Hyrje në studim	7
Metodologjia hulumtuese dhe kufizimet	8
Rezymeja ekzekutive	9
Radikalizmi që çon në ekstremizëm të dhunshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut	12
Informacione për vendin	12
Ekstremizmi i dhunshëm në kontekstin e Maqedonisë	14
Puna për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut	14
Perceptimet e stafit shkollor për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin	16
Njohuritë dhe vetëdija për rëndësinë e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm	16
Perceptimet e shkaqeve për incidentet e dhunshme në shkollat	19
Perceptimet e stafit shkollor për shkaqet e radikalizmit	22
Metodat aktuale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	24
Metodat e mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	26
Resurset dhe iniciativat e nevojshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në shkollat	29
Konkluzionet dhe rekomandimet	32
Konkluzionet	32
Rekomandimet	34
Ngritja e kapaciteteve për zbulimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm	34
Sistemi komunal për parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm	35
Vlerësimi i projektit	36
Aneksi 1: Pyetësi për personelin shkollor	38
Aneksi 2: Marrja e ekzemplarëve nga hulumtimi	49

HYRJE NË STUDIM

Ky Studim bazë zbatohet në kuadër të projektit “Eduko për të parandaluar - përforcimi i stafit shkollor dhe prindërve për ndërtimin e rezistencës tek të rinjtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, qëllimi i të cilit është që të zhvillohet një rezistencë te komuniteti ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes përforsimit të stafit shkollor dhe prindërve të nxënësve. Studimi i gjendjes fillestare i prezanton gjetjet e hulumtimeve në terren me përdorimin e qasjes së metodës së përzier: anketë reprezentative e stafit shkollor dhe intervista me përfaqësuesit e komunitetit (përfaqësuesit e komunave dhe policisë; si dhe përfaqësuesit e të dyja komuniteteve dominuese fetare në Maqedoninë e Veriut: komuniteti fetar ortodoks i krishterë dhe ai fetar islamik). Hulumtimi u zbatua gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 2018. Të dhënat statistikore pas kontrollit të kryer të cilësisë u analizuan me përdorimin e SPSS-së.

Në këtë studim janë dhënë të dhëna për nivelin e tanishëm të njohurive dhe aftësive të stafit shkollor për identifikimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Qëllimi i Studimit është të mundësojë drejtim specifik të këtyre aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të projektit “Eduko për të parandaluar” dhe vendosjen e indikatorëve për matjen e progresit në kuadër të këtij grupi qëllimor për radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Studimi në mënyrë konkrete përcakton nivelin e vetëdijes (duke përfshirë njohuritë, vlerat dhe qëndrimet) në lidhje me kërcënimin

e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm te stafi shkollor dhe komunal; identifikon mekanizmat e zhvilluar në nivel shkollor dhe/ose komunal për parandalim, identifikim dhe reagimin ndaj rasteve potenciale të radikalizimit (zbulimi i praktikave të mira potenciale); politika analitike të nevojshme për zgjidhjen adekuate të problemit (duke përfshirë edhe zhvillimin e aftësive të stafit shkollor dhe komunal, zhvillimin e materialeve mësimore dhe jashtëmësimore, mekanizmat e udhëzimit etj); përcakton metodat përmes të cilave mbledhen të dhëna dhe informacione të tjera për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe përhapet në mendimet e të anketuarve në drejtim të asaj se cilat resurse janë të nevojshme, cilat aktivitete duhet të ndiqen dhe cilat tema duhet të bëhen sfera të fokusimit në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Në përgjithësi, ky Studim bazë siguron një bazë informative sipas së cilës duhet të ndiqet dhe vlerësohet progresi dhe efektiviteti i projektit gjatë implementimit dhe pas përfundimit të projektit. Përveç kësaj, Studimi bazë informon për një nga pakot kryesore të aktiviteteve të projektit - Ngritja e kapaciteteve të stafit shkollor, prindërve dhe nëpunësve komunalë për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe zbulimin e shenjave të hershme të radikalizmit (Pakoja e punës 2). Gjetjet e Studimit, po ashtu, informojnë për zhvillimin e programit të trajnimit dhe mentorimit dhe vendosjen e sistemit komunal për parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm (Pakoja e punës 3)

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE KUFIZIMET

Në Studimin bazë përdoren të dhëna sekondare të mbledhura nga punët hulumtuese, artikujt dhe dokumentet zyrtare, si dhe të dhëna empirike të marra nga anketa, e cila shërben si burim kryesor i të dhënave. Me qëllim që të mblidhen të dhënat empirike, u përdorën metodologji kualitative dhe kuantitative, siç janë intervistat dhe anketa. Ky hulumtim u zbatua në 22 shkolla të mesme në Shkup dhe në komunat e Kumanovës, Tetovës dhe Gostivarit, të cilat janë sferat qëllimore të projektit. Shkollat janë multietnike dhe mbajnë mësim në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe. Anketës i janë përgjigjur 505 të punësuar në këto shkolla. Stafi shkollor mund të definohet si punëtor i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me nxënësit e shkollës dhe mund t'i përfshijë mësimdhënësit, personelin administrativ, drejtorët, psikologët, pedagogët dhe të tjerët, të cilët janë punësuar në shkollat. Me zbatimin e metodës së anketës sipas rastësisë dhe në përputhje me analizën e të dhënave demografike, 52% e të anketuarve kanë qenë shqiptarë etnikë, 43% kanë qenë maqedonas etnikë, ndërsa 5% nga grupet e tjera etnike. Anketa i ka përfshirë të gjithë psikologët, pedagogët në çdo shkollë dhe 20 mësimdhënës të tjerë nga çdo shkollë. Përzgjedhja e të anketuarve ishte e rastësishme. Mbledhja e të dhënave u organizua në çdo shkollë gjatë një dite. Me përdorimin e kësaj metode pritej të zvogëlohej potenciali i të anketuarve që të japin përgjigjet e dëshiruara sociale, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e temës.

Pyetësi kishte 35 pyetje hulumtuese, të cilat mund të ndahen në katër grupe pyetjesh: (I) Zbulimi i perceptimeve të dhunës, ekstremizmit, radikalizmit, metodave, mjediseve të indoktrinimit etj.; (II) Zbulimi i perceptimeve të faktorëve që ndikojnë mbi ndjeshmërinë e nxënësve ndaj radikalizmit; (III) Zbulimi i aktiviteteve që zbatohen në shkollë dhe përdorimi i metodave mësimore dhe programit mësimor për ballafaqim me indoktrinimin dhe radikalizmin

ndër nxënësit; (IV) Zbulimi i kapaciteteve aktuale dhe nevojat e ardhshme për trajnim për ballafaqim me radikalizmin në shkolla.

Pastaj, u zbatuan 40 intervista gjysmë të strukturuar me: stafin shkollor, përfaqësuesit e komunave, nëpunësit policorë të cilët punojnë me këshillat lokale për parandalim (LCPs) dhe punëtorët fetarë në secilën prej komunave qëllimore. Qëllimi i intervistave ishte që të mblidhen informacione të detajuara për praktikën e trajtimit të dhunës dhe rrënjët e miratimit të ideologjive radikale ndër të rinjtë; politikën aktuale dhe kornizat institucionale për t'iu përgjigjur ekstremizmit të dhunshëm dhe nevojat për përmirësimin e praktikave ekzistuese që të vendoset përgjigje efektive për trendet e radikalizmit.

Hulumtimi i këtij lloji në mënyrë të pashmangshme ballafaqohet me një numër të madh kufizimesh që duhet të merren parasysh gjatë nxjerrjes së konkluzioneve relevante dhe përgatitjes së rekomandimeve. Përveç kornizës kohore për zbatimin e aktiviteteve hulumtuese të këtij rangu në terren, brenda dy muajve, çështjes delikate dhe ndjeshmërisë së temës, ka pyetje që dalin nga zgjedhjet metodologjike që u zbatuan për hulumtim, por edhe nga disponueshmëria e të dhënave bazë.

Së pari, hulumtimi u zbatua në shkollat në mëngjes. Duke pasur parasysh se disa shkolla punojnë me ndërrime, në rezultatet e fundit ka një anshmëri zgjedhore, edhe pse ne siguroam përfshirjen e mësimdhënësve nga të dyja gjuhët në të cilat mbahet mësimi: gjuha maqedonase dhe ajo shqipe, me qëllim që të minimizohet efekti i grumbullimit të perceptimeve vetëm të një komuniteti.

Një tjetër kufizim ishte mungesa e mekanizmave të detyrimit për t'u siguruar përgjigje të plota dhe të drejta për të gjitha pyetjet. Kjo në masë të madhe varet nga vullneti i të anketuarit dhe nuk rekomandohet të ketë detyrim gjatë hulumtimit. Sepse pyetësi ishte voluminoz (shikojeni në Aneksin 1), kishte raste kur të anketuarit nuk u janë përgjigjur tërësisht të gjitha pyetjeve në anketë.

Që të minimizohet ndikimi i kësaj dukurie gjatë analizimit të rezultateve tona, vëmendje më të madhe u kushtuam pjesëmarrjeve në përqindje sesa numrave absolute nën çdo opsion për përgjigje.

Së fundmi, u ballafaquam me sfida për qasje deri te resurset sekondare dhe të dhënat statistikore për temën sepse për këtë temë nuk është zbatuar një tjetër hulumtim bazë. Të gjitha burimet e arritshme deri më sot janë konsultuar dhe përdoren në mënyrë përkatëse.

REZYMEJA EKZEKUTIVE

Çështja e cila kohët e fundit bëhet e rëndësishme në Ballkanin Perëndimor është çështja e ekstremizmit të dhunshëm. Tensionet etnike që ndërtoheshin me dekada dhe luftërat e viteve 1990-ta dhe në fillimin e viteve të 2000-ta lënë shumë plagë në vetëdijen e njerëzve të rajonit, të cilat kanë potencial që të hapen përsëri. Njëra e mënyrave në të cilat janë shprehur këto tensione në vitet e fundit është dukuria e ekstremizmit të dhunshëm. Në Maqedoninë e Veriut, konteksti i luftës post-qytetare, si dhe dominimi i paradokohshëm politik i partisë e cila kontribuoi për ndarje etnike në vend, duhet patjetër të merren parasysh kur mendohet për atë se si t'i qaset këtij fenomeni. Qasjet në kuadër të Maqedonisë së Veriut përshijnë përpjekjet e pushteteve kombëtare dhe komunale dhe forcave policore, organizatave të shoqërisë civile, shkollave dhe institucioneve fetare. Kjo qasje e gjerë, e cila përfshin më shumë faktorë, konsiderohet si mënyra më efektive për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel të vërtetë të rrënjëve të tij, kundrejt mbështetjes vetëm mbi forcat policore në një qasje të siguar. Ballafaqimi me ekstremizmin e dhunshëm përmes angazhimit të stafit shkollor (mësimdhënësit, drejtorët dhe nëpunësit administrativë) është një metodë jashtëzakonisht e dobishme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm te të rinjtë, me ç'rast

edukimi ose mungesa e edukimit është një komponent kritik për atë se nëse dikush do të zhvillojë qëndrime ekstremiste në jetën e tij.

Në studimin që vijon është dhënë ilustrimi bazë i stafit shkollor në tri komuna në Maqedoninë e Veriut ku ekstremizmi i dhunshëm ka shënuar disa rritje në kohët e fundit. Ky studim pastaj ka për qëllim që t'i identifikojë zbrazëtirat në njohuritë e stafit shkollor, të cilat mund të zgjidhen me programin e ardhshëm për trajnim, të zbatuar nga Hedaja dhe QHKP-ja. Studimi bazë përcakton nivelet e njohjes së lëndës, kapacitetet për t'iu përgjigjur radikalizmit dhe nevojave për trajnimin e grupit qëllimor për në të ardhmen. Marrë në përgjithësi, qëllimi i Studimit bazë është që të sigurohet një bazë informative me të cilën do të ndiqet dhe do të vlerësohet progresi dhe efektiviteti i projektit gjatë implementimit dhe pas përfundimit të projektit. Ky Studim bazë vepron si pikënisje për aktivitetet të cilat do të zbatohen në kuadër të projektit rrjedhës në shkolla, kështu që aktivitetet nuk do të përsëriten, e as nuk do të kapërcehen hapat pa u vendosur një bazë përkatëse për aktivitetet. Pastaj, Studimi bazë vepron si mjet kuantitativ dhe kualitativ për matje me të cilin mund të maten të dhënat. Kjo do të ndihmojë në verifikimin e efektivitetit të aktiviteteve aktuale, të cilat pastaj mund të zbatohen në mënyrë potenciale në kontekste të tjera me qëllim që të ballafaqohen me ekstremizmin e dhunshëm në një nivel më të përgjithshëm.

Studimi bazë përbëhet nga disa komponentë. Ata përfshijnë: (1) perceptimet themelore të të anketuarve për ekstremizmin e dhunshëm dhe terminologjinë e tij, (2) perceptimet e tyre për arsyet për incidentet e dhunshme në shkolla, (3) si reagojnë shkolla dhe institucionet e tjera në rastet e ekstremizmit të dhunshëm, (4) si mbliidhen të dhënat dhe informacionet e tjera për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe (5) mendimet e tyre për atë se cilat resurse janë të nevojshme ose cilat aktivitete duhet të ndërmerren, si dhe për atë se në cilat tema duhet të fokusohen përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Marrë në përgjithësi, në lidhje me perceptimet bazë (1), duket se stafi shkollor nuk ka

perceptim të qartë lidhur me dallimin midis nocioneve kryesore në orbitën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm ose për atë se çfarë në të vërtetë është ekstremizmi të dhunshëm. Po ashtu, ata nuk ishin të njoftuar për shumicën e strategjive kombëtare në këtë temë. Pastaj, është interesante se shpesh vëreheshin dallime në mënyrën në të cilën maqedonasit etnikë ose shqiptarët etnikë i perceptonin ngjarjet e njëjta, kështu që një numër i madh i maqedonasve konsideronin se në vitin e kaluar ka pasur më shumë ngjarje të dhunshme që i kanë shkaktuar shqiptarë etnikë. Lidhur me arsyet për incidentet e dhunshme në shkollat (2), vërehet një e dhënë interesante se numri më i madh i të anketuarve kanë besuar se incidentet e dhunshme në shkollat janë shkaktuar nga një faktor që është i ndryshëm nga faktorët fetarë, etnikë ose faktorët fetarë dhe etnikë. Është interesante se kjo kategori “tjetër” për shpjegimin e incidenteve të dhunshme kishte një përqindje jashtëzakonisht të lartë të të anketuarit në Shkup. E dhëna përfundimtare interesante që vërehet lidhur me incidentet e dhunshme ishte dallimi kryesor midis perceptimeve të stafit shkollor dhe të përfaqësuesve të komunave në cilëndo komunë të dhënë. Punëtorët e shkollave shumë më tepër se përfaqësuesit e komunave insistonin për ekzistencën e incidenteve të dhunshme në shkolla dhe për rritjen e numrit të tyre, ndërsa përfaqësuesit e komunave theksuan se ato shifra zvogëlohen apo se nuk ka pasur incidente. Kjo mund të tregojë një komunikim joadekuat në mes të komunës dhe shkollave në të apo një perspektivë të ndryshme lidhur me rolet e ndryshme që duhet të luajnë pjesëmarrësit. Sa i përket përgjigjeve për rastet e ekstremizmit të dhunshme (3), shumë komuna ndjekin atë që mund të quhet metodë për bashkëpunimin e përgjigjeve me më shumë pjesëmarrës që janë të përfshirë në faza të ndryshme (mësimdhënësit, prindërit, komunat, policia). Pastaj, disa komuna kanë ndërmarrë aktivitete parandaluese në kohën e ndjeshmërisë etnike (për shembull, periudhat parazgjedhore). Është shumë e rëndësishme të theksohet se shumica e të anketuarve (77%) ose kanë kundërshtuar ose nuk e dinë nëse bashkësia fetare duhet të përfshihet në qoftë se ka pasur një incident të dhunshëm me

motive fetare në shkollë, që është në kundërshtim me filozofinë e shumë iniciativave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat zakonisht duan t'i përfshijnë udhëheqësit fetarë.

Kur bëhet fjalë për atë se si mbledhen të dhënat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (4), u theksua se mësimdhënësit duhet të jenë vija e parë për mbledhjen e të dhënave për nxënësit, e gjithashtu duhet të garantohet se shkolla nuk do të shndërrohet në një dorë të zgjatur të policisë, e cila do të kryejë një skringing ose hetim për incidente potenciale ose ekstremistë. Për mënyrat në të cilat mbledhen të dhënat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) i përmendi disa burime të informacioneve, duke përfshirë, në një masë të konsiderueshme, mediat sociale, ndërsa përfaqësuesit e komunave dhe udhëheqësit fetarë ishin të paqartë dhe kundërthënës kur i identifikuan burimet të cilat i përdorin për mbledhjen e të dhënave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, gjë e cila që jo vetëm që mund të ndikojë mbi besueshmërinë dhe validitetin e të dhënave (si dhe ekzistimi i tyre në përgjithësi), por ato gjithashtu mund të jenë një kërcënim për përpjekjet, duke e marrë parasysh se parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm është një temë e ndjeshme dhe informacionet për këtë duhet të shqyrtohen me vëmendje, si dhe të formulohen me vëmendje.

Së fundmi, lidhur me atë se cilat resurse janë të nevojshme, temat të cilat duhet të përfshihen dhe kush duhet të përfshihet, mësimdhënësit i theksuan bazat e ekstremizmit të dhunshëm dhe tolerancat fetare dhe etnike si tema të dobishme që duhet të shtohen në planin e mësimin. Lidhur me trajnimin e tyre, një shumicë e madhe e mësimdhënësve nuk kanë ndjekur trajnim në temën e ekstremizmit të dhunshëm ose tolerancës etnike/fetare në pesë vitet e fundit (78%). Atëherë nuk habit fakti se kur bëhet fjalë për resurse ose aktivitete që janë të nevojshme, mësimdhënësit dëshironin më shumë trajnime dhe/ose më shumë kuadro të trajnuara për çështjet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Ata theksuan në mënyrë shtesë nevojën për një qasje sistemore dhe

të standardizuar ndaj parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në shkollat në vend të qasjes ad-hok, e cila është e pranishme aktualisht (një nga konkluzionet kryesore të këtij raporti). Sa i përket institucionit kryesor përgjegjës për çështjet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, mësimdhënësit identifikuan shkollat në kombinim me familjet, si dhe burime të ndryshme mediale (tradicionale dhe sociale). Derisa MPB-ja insistonte për një qasje të integruar të të gjithë aktorëve, përfaqësuesit e komunave ishin të paqartë dhe jo precizë për këtë çështje (me përjashtim të Kisella Vodës, shikojeni raportin), ndërsa udhëheqësit fetarë propozuan një bashkëpunim midis shkollave dhe autoriteteve kombëtare/komunale.

Është e qartë se është i nevojshëm një program për ngritjen e kapaciteteve të stafit shkollor dhe nëpunësve komunalë kur bëhet

fjalë për përgjigjet e ndryshme institucionale të ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut. Stafi shkollor kërkon trajnime për bazat e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe tolerancën etnike/religjioze të cilat do të sigurohen në një lokacion të caktuar nëpërmjet projektit “Eduko për të parandaluar”, ndërsa institucionet fetare dhe komunat mund të kenë dobi nga trajnimet për mbledhjen e të dhënave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Projekti për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, i cili dëshiron t’i përfshijë institucionet religjioze në punën e tij, ndoshta do të dëshirojë ta rishqyrtojë atë ide në bazë të perceptimit të këtyre palëve të prekura. Së fundmi, një qasje më e sistematizuar dhe më e standardizuar në shkollat, ku ka një protokoll për atë se si t’u përgjigjet incidenteve të ekstremizmit të dhunshëm te nxënësit, është e një rëndësie të madhe.

RADIKALIZMI QË ÇON NË EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

SITUATA E LIDHUR ME EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM (EDH) NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Regjistrimi i fundit në Maqedoni, i cili u zbatua në vitin 2002, tregoi se numri i popullsisë ishte 2.022.547 banorë. Nga kjo popullatë, 64% janë maqedonas etnikë. Grupi tjetër më i madh etnik janë shqiptarët etnikë, të cilët përbëjnë 25.17% të popullsisë së përgjithshme. Grupi i tretë më i madh etnik janë turqit etnikë, me 3.85%. Ka edhe disa grupe të tjera etnike që janë me përqindje të parëndësishme të popullsisë. Nga popullata e përgjithshme, 33.3% janë nga feja myslimane, ku besimi fetar është i ndarë pothuajse në vija etnike, me ç'rast shumica dërrmuese e maqedonasve etnikë janë lindorë-ortodoksë, ndërsa shumica e shqiptarëve etnikë janë myslimanë (Enti Shtetëror i Statistikave, viti 2002). Edhe pse në përgjithësi ekziston një bashkëjetesë e qetë midis grupeve të ndryshme etnike dhe religjioze në Maqedoninë e Veriut, ka edhe tensione të caktuara dhe edhe pse Maqedonia e Veriut në masë të madhe ka shmangur dëme më të mëdha nga konfliktet që dolën nga shkatërrimi i ish-Jugosllavisë, tensionet në vend arritën kulmin në konfliktin e armatosur në vitin 2001. Ky konflikt afatshkurtër ishte

mes Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe forcave të armatosura të Maqedonisë. Në këtë konflikt u vranë rreth 100 luftëtarë të UÇK-së, ndërsa nga ana e forcave të armatosura të Maqedonisë ky numër ishte 75 maqedonas (Bender 2013, 341).

Konflikti i armatosur në vitin 2001 rezultoi me vdekjen e rreth 205 njerëzve - shumë më pak se rreth 140.000 njerëzve që u vranë në luftërat e viteve 1990 në Bosnjë dhe Kroaci (Qendra ndërkombëtare për drejtësi të tranzicionit, 2009, 1). Marrëveshja e Ohrit (MO) solli fundin e konfliktit gati 10-mujor dhe vendosi të drejtat e pakicës shqiptare etnike në Maqedoninë e Veriut dhe rregullat për ndarjen e pushtetit mes partive politike maqedonase dhe shqiptare. Edhe pse marrëveshja i vendosi korrektorët juridikë për humbjet dhe diskriminimin të cilin e ndiejnë shqiptarët etnikë, deri më sot nacionalizmi dhe narrativët e superioritetit etnik përhapen dhe shfrytëzohen nga të dy grupet etnike (Popovska dhe Ristoska 2015, 63).

Narrativët e frikës në të dy anët, të cilët kulmuan në konfliktin e vitit 2001, ndërtoheshin dhe fokusoheshin me dekada të tëra në përjashtimin e kuptuar dhe faktik të shqiptarëve etnikë në shoqërinë e Maqedonisë. Ky përjashtim u vërejt në sferat politike, ekonomike dhe sociale. Te pala etnike maqedonase, narrativi i frikës fokusohet në frikën e humbjes së statusit të shumicës dhe “vendit të maqedonasve”. Edhe pse narrativët e frikës nuk mund ta shpjegojnë në mënyrë të pavarur ekstremizmin e dhunshëm që ekziston në Maqedoninë e Veriut, ata dhe konflikti i armatosur në vitin 2001 kanë një domethënie thelbësore që të kuptohet konteksti i pikëpamjeve ekstremiste të shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe janë të nevojshme për të kuptuar situatën sociale nga ana e lexuesit.

Edhe pse ndoshta janë më të mira se në vitin 2001, marrëdhëniet midis dy etnive në vend megjithatë mbeten të brishta. Që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit, e sidomos në vitet pas vitit 2010, vendi i përjetoi disa raste më të vogla të konflikteve etnike. Këtu janë sulmet e motivuara etnikisht, protestat e dhunshme, rrahjet dhe sulmet ndaj policisë. Është me rëndësi të veçantë të theksohet se incidentet e këtilla zakonisht rriten gjatë periudhave parazgjedhore, të cilat ndoshta ndodhin për shkak të partive politike në të dyja anët, të cilat nxisin tensione etnike si pjesë e sigurimit të mbështetjes politike.

Tensionet ndërmjet dy grupeve etnike shpesh manifestohen në mënyra të kundërta dhe reciproke përforcuese. Në përgjithësi, shqiptarët përjetojnë diskriminimin e vërtetë dhe të perceptuar nga maqedonasit etnikë. Maqedonasit etnikë, nëpërmjet forcimit të shqiptarëve etnikë, kanë përjetuar një humbje të perceptuar të kuptimit dhe statusit të shumicës. Këto sfera të ndjeshmërisë dhe narrativët të njëpasnjëshëm mund t'i bëjnë narrativët e dhunshëm ekstremistë të jenë më tërheqës për të dyja palët.

Po ashtu është shumë e rëndësishme që të shënohet se ekziston një konflikt më i ri politik që e ka kapluar Maqedoninë e Veriut dhe

është shumë e rëndësishme që të kuptohet imazhi i ekstremizmit të dhunshëm në vend. Në vitin 2015, në vend u paraqit një krizë politike, kur Qeveria e mëparshme, nën udhëheqjen e kryeministrit Nikolla Gruevski, ishte e përzier në skandalin e përgjimit masovik me implikimin e partisë së tij, VMRO-DPMNE (Beçevi, viti 2017). Disa muaj pas skandalit, tensionet etnike u aktivizuan përsëri kur në maj të vitit 2015 ndodhi një konflikt vdekjeprurës midis grupit të armatosur të shqiptarëve etnikë dhe policisë së Maqedonisë në Kumanovë, qytet që gjendet në pjesën veriore të vendit. Pas dështimit të shërbimit të kundërzbulimit për ta parandaluar këtë konflikt, drejtori i shërbimit të kundërzbulimit, Sasho Mijallkov dhe Ministri e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovaska dhanë dorëheqjet e tyre. Marrëveshja në Përzhinë u nënshkrua në qershor të vitit 2015 për t'i dhënë fund konfliktit¹, me zgjedhje për qeveri të re të cilat do të mbahen në dhjetor të vitit 2016 (Komisioni Evropian, viti 2015).

Gjatë tërë krizës politike, e cila zgjati deri në formimin e qeverisë së re nga ana e partia opozitare LSDM në qershor të vitit 2017, tensionet etnike shfrytëzoheshin për të përdorur propagandë, torturë me frikë dhe për të ndërtuar narrativë. Pas zgjedhjes së një shqiptari për kryetar të Parlamentit, që shkaktoi një sulm të ndërtesës së Parlamentit, kryesisht nga ana e nacionalistëve maqedonas dhe lëndime të 77 deputetëve në një ngjarje, e cila prej atëherë për disa është e njohur si një shembull i ekstremizmit të dhunshëm të së djathtës në Maqedoninë e Veriut. Përveç kësaj, në periudhën parazgjedhore u paraqitën raste të përplasjeve ndëretnike në transportin publik dhe në ngjarjet sportive². Ky kontekst ka

¹ Marrëveshja e Përzhinës (2015) ndërpreu krizën politike në Maqedoninë e Veriut, e cila filloi me zbulimin e përgjimit të pjesës së madhe të popullatës në Maqedoni nga qeveria e VMRO-DPMNE-së. Ajo ishte arsyeja për dorëheqjen e Kryeministrit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, formimin e Prokurorisë Speciale Publike për skandalin e përgjimit dhe formimin e një qeverie që do të kujdeset dhe do ta udhëheqë vendin në zgjedhje në vitin 2016, me ç'rast do të përcaktohet formimi i administratës së partisë opozitare LSDM në qershor të vitit 2017.

² Jonuzi, Afrim. “Situata në vend shkaktonte nacionalizëm (The situation in the country leads to nationalism)”. 21 TV. 27.02.2017 <https://bit.ly/2rkV0u4>

një rëndësi thelbësore për të kuptuar klimën aktuale, e cila mund të ishte e volitshme për ekstremizmin e dhunshëm.

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KONTEKSTIN E MAQEDONISË

Në vitin 2018, 150 shtetas të Maqedonisë kanë ikur nga vendi për t'u bashkëngjitur formacioneve paraushtarake në Irak dhe Siri (Stojkovski dhe Kallajxhiovski, 2018). Ky numër është numri më i madh për kokë banori i luftëtarëve të huaj terroristë nga popullata myslimane në cilindo vend të Ballkanit Perëndimor. Maqedonia e Veriut, po ashtu, ka numrin e dytë më të madh të luftëtarëve të huaj të kthyer terroristë (80) në kufijtë e saj, ku vetëm Kosova ka më shumë (130) (Azinoviq, 2018,9). Këto shifra të rëndësishme ngrenë pyetje për nivelin e ekstremizmit jo të dhunshëm te popullata myslimane në Maqedoninë e Veriut (Stojkovski dhe Kallajxhiovski, 2018,12), me atë që derisa në këtë vend ka një numër relativisht të vogël të sulmeve terroriste, ende është e mundshme që të radikalizohen njerëz brenda kufijve të Maqedonisë pa u zbatuar paraprakisht sulme të dhunshme. Ky radikalizëm “i pavërejtur” mund të ketë ndikime negative mbi popullatën vendore, sidomos në të ardhmen.

Megjithatë, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut deklaroi se nga viti 2017 nuk ka regjistruar raste të shkuarjes së luftëtarëve nga Maqedonia e Veriut jashtë vendit. Po ashtu, nga viti 2017 flukset e luftëtarëve të huaj jashtë Maqedonisë Veriore janë ndërprerë. Arsyt kryesore të kësaj ndërprerjeje ishin vështirësia për të arritur në Irak dhe Siri falë miratimit të legjislativit të ri me qëllim të parandalimit të terrorizmit, si dhe humbja e të gjitha territoreve nga ana e ISIL të cilat i posedonte në një moment në Siri dhe Irak (Stojkovski dhe Kallajxhiovski, 2018).

Megjithatë, edhe përkundër këtyre dukurive kjo nuk do të thotë se përkrahja e ideve ekstremiste gjithashtu është ndërprerë; kjo do të thoshte se ekstremistët të cilët janë të prirur ndaj dhunës dhe janë lanë pa rrugëdalje jashtë, do të mund të ishin kërcënim serioz për sigurinë e brendshme të Maqedonisë së Veriut. Kjo mundësi i ngre çështjet politike për Maqedoninë lidhur me sulmet e brendshme. Pastaj, duke e pasur parasysh numrin e madh të luftëtarëve të huaj terroristë të cilët u kthyen në Maqedoninë e Veriut nga luftërat në Irak dhe Siri, me një rëndësi thelbësore është që përpjekjet për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm t'u fokusohen po ashtu luftëtarëve të kthyer. Megjithatë, mungesa e programeve për riintegrim dhe rehabilitim të luftëtarëve të kthyer në Maqedoninë e Veriut e komplikon problemin dhe kjo nuk është mirë për ardhmërinë (Stojkovski dhe Kallajxhiovski, 2018).

PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM – PUNA NË MAQEDONI

Në shkurt të vitit 2018, Republika e Maqedonisë së Veriut e miratoi strategjinë e saj të parë për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si pjesë e politikës më të gjerë për parandalimin e terrorizmit. Kjo strategji, pjesë e një strategjie më të madhe katërvjeçare (2018-2022), u iniciua nga administrata e Zoran Zaevit dhe ka për qëllim që t'i harmonizojë përpjekjet për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe përpjekjet antiterroriste të Maqedonisë së Veriut me strategjitë dhe metodat e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Këto përpjekje erdhën disa vite më vonë nga miratimi i strategjive të ngjashme nga ana e qeverive të tjera të Ballkanit Perëndimor. Edhe pse nuk janë mjaftë gjithëpërfshirëse, ato janë më shumë të fokusuara në aspektet e sigurisë dhe zbatimin e Ligjit për parandalimin e ekstremizmit të

dhunshëm dhe në masë të madhe injorojnë faktorët shoqërorë dhe arsimorë dhe metodat e parandalimit.

Sa i përket personelit qeveritar përgjegjës për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, para vitit 2017 nuk ka pasur trup koordinues. Ka pasur një koordinator për parandalimin e terrorizmit (luftën kundër terrorizmit), i cili gjithashtu ka punuar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm për një periudhë të shkurtër. Në vitin 2017 u emëruan dy koordinatorë që të fokusohen në luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, që ishte një shenjë pozitive për kalimin e Qeverisë së Maqedonisë nga perspektiva e zbatimit të ligjit për çështjen në një qasje më holistike. Megjithatë, këta koordinatorë nuk kanë

materiale dhe hapësirë për kryerjen e detyrave të tyre të punës dhe gjithashtu janë përkrahur nga institucionet ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë OSBE-në dhe ambasadat e SHBA-së dhe të Mbretërisë së Bashkuar.

Disa përpjekje të shoqërisë civile lidhur me luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm janë zbatuar, përveç atyre të cilat përfshijnë projektin ndërkombëtar për shkolla amtare, të cilin e zbatojnë Gra pa kufij në Çair dhe projektin komunal të zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) në Shkup. Po ashtu, ka projekte hulumtuese në këtë temë të zbatuara nga ana e Analitika Tink-Tenk, IOM dhe Këshilli Britanik.

PERCEPTIMET E STAFIT SHKOLLOR PËR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIN

NJOHURITË DHE VETËDIJA PËR RËNDËSINË E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Në bazë të hulumtimit të zbatuar për këtë raport, përshtypja e përgjithshme është se mësimdhënësit e shkollave të mesme nuk janë tërësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm sepse ata rrallë mund t'i dallojnë konceptet siç janë “ekstremizëm”, “radikalizëm”, “ekstremizëm i dhunshëm”, “terrorizëm” dhe radikalizmi”. Zakonisht njerëzit jepnin përgjigje duke përdorur kombinimin e këtyre termave për ta shënuar atë. Prandaj, është i rëndësishëm trajnimi i stafit shkollor për njohuritë themelore teorike me qëllim që ta kuptojnë më mirë këtë çështje. Kjo mund të bëhet me atë që do të sigurohen për ta shembuj të vërtetë (për shembull video, studime të rasteve etj.) për atë se çfarë në fakt do të thonë këto koncepte që të mos keqpërdoren fjalët dhe të mos zgjerohen keqkuptime.

Është thelbësore që të shënohet perceptimi publik për shkallën e kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar në Maqedoninë e Veriut. Vetëm 16 nga të anketuarit i identifikuan disa prej tyre si një nga kërcënimet më të mëdha për sigurinë e

Maqedonisë së Veriut, me korrupsionin, pasigurinë politike dhe tensionet etnike që i përbëjnë tre kërcënimet e para. Nga ana tjetër, kur u pyetën për kërcënimet më të mëdha për sigurinë në botë, tre kërcënimet e para për të anketuarit ishin terrorizmi, kriza globale migruese dhe krimi i organizuar. Ndërsa ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi fetar nuk ishin në tre kërcënimet e para, edhe të dyja opsionet u identifikuan prej rreth 44% e të anketuarve. Është interesante të shënohet ky dallim midis Maqedonisë së Veriut dhe perceptimeve për botën si tërësi. Pastaj, fakti që shumica mendojnë se tensionet etnike paraqesin kërcënim në kuadër të Maqedonisë së Veriut duhet të zbatohet në kuadër të projektit.

Hulumtimi pastaj tregoi se perceptimi i nxënësve që të bëhen të radikalizuar në bazë fetare është shumë më i madh te të anketuarit në Shkup sesa në vendet e tjera. Edhe pse perceptimet nuk e shënojnë faktin, kjo e dhënë e rëndësishme tregon se Shkupi duhet të jetë një sferë fokusi kur bëhet fjalë për punë me perceptimet për arsyet dhe arsimin e radikalizmit.


Në lidhje me profilin e personave të cilat mund t'i nënshtrohen radikalizmit dhe të bëhen të radikalizuar, perceptimi i përgjithshëm te stafi shkollor ishte se adoleshentët, të cilët vijnë nga familjet më të varfra dhe kanë statusin më të ulët social në përgjithësi, nënshtrohen më shumë ndaj pranimi të ideologjive radikale, por gjithashtu janë të prirur ndaj llojeve të ndryshme të dhunës brenda dhe jashtë shkollës. Familjet jofunksionale, më të mëdha dhe më pak të arsimuara gjithashtu shihen si mjedise ku mund të zhvillohet kjo sjellje. Derisa kjo ishte një mundësi në të cilën perceptimi i fenomeneve ishte i njëjtë te stafi shkollor, pa dallim të lokacionit ose përkatësisë etnike, kishte edhe dallime të mëdha kur bëhet

fjalë për perceptimin e çështjeve të tjera. Lidhur me incidentet e dhunshme në shkollat ku punojnë, ekzistonin dallime në perceptimet e maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë. Ndër maqedonasit etnikë, 22.75% nga të anketuarit mendojnë se ka pasur incidente të dhunshme gjatë 18 muajve të kaluara.

Nga ana tjetër, 54.98% mendojnë se në këtë periudhë kohore nuk ka pasur incidente të dhunshme, ndërsa 21.8% nuk mund të kujtohen. Nga këndvështrimi i shqiptarëve etnikë, 14.86% mendojnë se në këtë periudhë ka pasur incidente të dhunshme, 63.86% pretendojnë se nuk ka pasur incidente, ndërsa 21.29% nuk kujtohen.

Fotografia 1: Perceptimi për radikalizmin e nxënësve në bazë fetare në territorin e Qytetit të Shkupit


Do you think that in your school there is a process of radicalization of students on religious basis?



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së te stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

Fotografia 2: Perceptimi për incidente të dhunshme gjatë vitit 2017 dhe 2018 në Maqedoninë e Veriut te maqedonasit etnikë


During 2017 and 2018, had there been violent incidents in the school?



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së te stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

Dallimet e mëdha midis shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë duhet të shënohen në lidhje me atë se si grupe të ndryshme etnike mund të shikojnë ngjarje të ndryshme dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aktiviteteve për trajnim. Shifrat në nivel komunal i ndjekin ato të nivelit kombëtar, me ç'rast Shkupi edhe një herë bën përjashtim. Te personat e anketuar nga stafi shkollor nga Shkupi, 31.94% mendojnë se gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018 ka pasur incidente të dhunshme në shkollën e tyre, kundrejt 19% nga personat e anketuar nga stafi shkollor në nivel kombëtar. Përkundrazi, 45.83% pretendojnë se nuk ka pasur incidente të dhunshme në shkollat ku punojnë në këtë periudhë, ndërsa 21.53% nuk kujtohen.


Fotografia 3: Perceptimi për incidente të dhunshme në shkollat gjatë vitit 2017 dhe 2018 në Maqedoninë e shqiptarët etnikë



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së të stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

Mund të jetë e rëndësishme që shumë më tepër persona të anketuar në Shkup sesa në vend si tërësi mendojnë se në vitin paraprak ka pasur raste të një ngjarjeje të dhunshme në shkollën e tyre. Kjo edhe më shumë e potencon idenë se Shkupi duhet të jetë sferë me fokus të veçantë për aktivitetet e trajnimit, si në lidhje me perceptimet për dhunë në shkollat, ashtu edhe në lidhje me vetë dhunën, sepse perceptimi për dhunë është shumë më i madh se perceptimet për dhunë në vend si tërësi. Kjo mund t'u referohet edhe ndarjeve më të mëdha etnike që ekzistojnë në Shkup, e sidomos në lidhje me vendbanimet dhe shkollat e karakterizuara me tensione etnike.

Fotografia 4: Perceptimi për incidente të dhunshme gjatë vitit 2017 dhe 2018 në Shkup



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së të stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

PERCEPTIMET E SHKAQEVE PËR INCIDENTET E DHUNSHME NË SHKOLLAT


Një fakt i rëndësishëm lidhur me incidentet e dhunshme në shkollat, po ashtu ishin perceptimet e të anketuarve për atë se pse kanë ndodhur ato. Ndër të anketuarit në Shkup, të cilët paraprakisht kanë raportuar incidente të dhunshme në shkollën e tyre, 8% mendojnë se dhuna është e motivuar nga feja, 18% se dhuna është e motivuar nga etnia, ndërsa 9% se dhuna është e motivuar nga feja dhe etnia.

Gati dy të tretat e të anketuarve (65%) besojnë se prejardhja e dhunës duhet të ndiqet në një çështje tjetër, që lë një pikëpyetje

të madhe për prejardhjen e dhunës në shkollat e mesme në Shkup. Megjithatë, duket se për pyetjen për incidentet e dhunshme në shkollat e mesme të Shkupit kishte përgjigje të forta që të mendohet se është më shumë një problem etnik sesa një çështje religjioze. Do të ishte e dobishme që në hulumtimet e mëtejshme ose fokus-grupet të pyeten se çfarë besojnë se është faktori shkaktar për incidentet e dhunshme ose të zgjerohen përgjigjet e mundshme të pyetjeve.


Nga këndvështrimi i mësimdhënësve të shkollave të mesme, u prezantuan arsye të ndryshme për incidentet e dhunshme. Vetëm një mësimdhënëse dha komente për incidentet sporadike në shkollën e saj, por sikurse disa kolegë të saj në Shkup, ajo i lidhi ato kryesisht me pubertetin (Int. 1, KU). Mësimdhënësit nga Tetova komentojnë se incidentet etnike dhe fetare ose nuk ekzistojnë ose zhduken tërësisht, por disa prej tyre e lidhin mungesën

Fotografia 5: Prejardhja e dhunës në shkollat në Maqedoninë e Veriut



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së të stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

Fotografia 6: Prejardhja e dhunës në shkollat e Shkupit



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së të stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

e incidenteve me ndarjen e nxënësve në ndërtesa të ndryshme shkollore apo ndërrime të ndara shkollore (Int. 1, TE dhe Int. 3, TE). Një nga mësimdhënësit dha koment se nganjëherë ndodhin incidente të vogla, kryesisht për shkak të tensioneve politike të cilat i krijojnë partitë politike (Int. 6, TE). Ky numër i madh i përgjigjeve e demonstroi kompleksitetin e incidenteve të dhunshme në shkollat dhe faktorët e shumtë të cilët potencialisht mund të shkaktojnë ose reciprokisht të përforcohen njëri me tjetrin, si dhe pyetjet në lidhje me atë nëse incidentet janë në rritje apo në rënie, pa dallim nëse ato janë një çështje etnike/fetare apo jo dhe nëse politikat e ndryshme të fokusuara në zvogëlimin e numrit të incidenteve kanë efektin e dëshiruar ose vetëm i përkeqësojnë gjërat. Projekti duhet t'i ketë parasysh porositë dhe pyetjet politike për pubertetin kur bëhet fjalë për incidente të dhunshme në shkollat. Kjo ndodh për shkak se ndryshimet gjatë pubertetit ndodhin në të njëjtën kohë me proceset e tjera komplekse që rrethojnë zhvillimin e mendimeve radikale të rinjtë dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në radikalizmin e atyre njerëzve të rinj. Kryqëzimi i përkatësisë etnike dhe politikës në Maqedoninë e Veriut, e sidomos gjatë krizës politike në disa vitet e fundit, duhet të shqyrtohet në mënyrë të veçantë kur bëhet fjalë për radikalizmin e të rinjve për shkak të porositë të ndryshme politike.

Pastaj, lidhur me arsyet për incidentet e dhunshme në shkollat, përfaqësuesi i Komunës së Kumanovës e konfirmoi atë që e thanë mësimdhënësit e shkollave të mesme, por mendon se ndarja etnike e shkollave është zgjidhje, e jo problem (Int. 6, KU). Kolegu i tij në Tetovë, gjithashtu komentoi se në vitet e fundit nuk është raportuar asnjë dhunë etnike dhe fetare (Int. 8, TE). Befasisht, vërejtje të ngjashme dha edhe përfaqësuesi i intervistuar nga administrata komunale në Gostivar (Int. 6, GV), të cilat në masë të madhe dallohen nga ato të mësimdhënësve të shkollave të mesme. Nga ana tjetër, sipas përfaqësuesit të njëjtë komunal nga Kumanova, nuk ka raportime për raste të dhunës fetare (Int. 13, SK). Dy përfaqësuesit e tjerë të policisë nuk kanë raportuar asnjë

dhunë fetare ose etnike (Int. 1, TE dhe GV), ndërsa i anketuari nga Kumanova theksoi se në vitet e fundit vërehet një rënie e madhe e incidenteve më të vogla etnike (Int. 7, KU). Është e rëndësishme që përgjigjet e përfaqësuesve të autoriteteve komunale dallohen nga ato të mësimdhënësve dhe duhet t'u kushtohet vëmendje kur paralajmërohen politikat në lidhje me parandalimin e dhunës në shkollat dhe politikat për zgjidhjen e saj, duke i marrë parasysh përvojat e ndryshme të përfaqësuesve të komunave dhe të mësimdhënësve. Kjo gjithashtu tregon kompleksitetin e paraqitjes së dhunës në shkollat, duke e pasur parasysh se mësimdhënësit dhe nëpunësit komunalë duket se shohin të dhëna të ndryshme ose duket se kanë një përvojë dhe perspektivë shumë të ndryshme, sipas rolit që ata duhet të luajnë në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Është gjithashtu e rëndësishme se nga aspekti i policisë, incidentet po zvogëlohen, por sipas shumicës së mësimdhënësve, ato nuk ulen. Kjo sugjeron se mund të ketë disa mangësi në shkëmbimin e informacioneve midis shkollave dhe forcave lokale të policisë.


Për këtë qëllim, anketimi i QHKP-së i stafit shkollor për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin pasqyron kuptimin e kompleksitetit jo vetëm si një dukuri, por gjithashtu edhe si mjedis të përshtatshme për indoktrinimin dhe radikalizmin e të rinjve. Në fakt, në nivel kombëtar, stafi shkollor theksoi internetin dhe mediat sociale si vendi më i përshtatshëm për indoktrim dhe radikalizëm (70,89%), pastaj institucionet fetare dhe shkollat fetare (46,73%) dhe grupet e moshatarëve (31,09%) (Fotografia 3). Sa i përket strukturës etnike të të anketuarve, nuk ka dallim të madh. Zgjedhjet e shqiptarëve etnik i ndjekin ato në nivel kombëtar, ndërsa maqedonasit u vendosën për të njëjtat dy zgjedhje kryesore, duke i vënë organizatat rinore partiake si mjedisi i tretë relevant për indoktrim dhe radikalizëm (33,64%) në vend të grupeve të moshatarëve. Sa i përket komunave, edhe një herë interneti dhe mediat sociale konsiderohen si ambienti më i përshtatshëm për indoktrim dhe radikalizëm.

Fakti i fundit i rëndësishëm lidhur me perceptimet e përgjithshme të ekstremizmit të dhunshëm të të anketuarit ishte mungesa e tyre e njohurive të strategjive kombëtare në këtë temë. Katër kategoritë e të anketuarve u pyetën për atë se *sa kanë njohuri për ekzistimin e strategjive kombëtare dhe planeve aksionare për luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*. Vetëm përfaqësuesit e stafit shkollor, të cilët morën pjesë në trajnimin bazë të OSBE-së për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, kishin njohuri për ekzistimin e këtyre dokumenteve dhe Komitetin kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit (Int. 1, SK; Int.5, TE, Int. 6, TE, Int. 1, GV, Int. 2, GV dhe Int. 4, GV). Asnjë nga të anketuarit

e tjerë nuk ka dëgjuar paraprakisht as për strategjitë kombëtare dhe planet aksionare, as për Komitetin kombëtar. Prandaj, është e rëndësishme të përmendet strategjia kombëtare dhe plani aksionar kombëtar në trajnimin e organizuar në kuadër të projektit “Eduko për të parandaluar”. Çdo projekt i mëtejshëm do të bënte mirë për ngritjen e vetëdijes në mesin e palëve të prekura për ekzistimin e këtyre strategjive, përmbajtjen e tyre dhe rolin e tyre personal në kuadër të këtyre strategjive dhe çfarë lloj iniciativash po ndodhin që mund të ndikojnë mbi to dhe si mund të marrin pjesë ato. Gjithashtu, do të ishte e rëndësishme që të përfshihen këto strategji, si dhe Komiteti kombëtar në trajnimet e ardhshme në këtë temë në Maqedoninë e Veriut.

Fotografia 7: Mjediset më të përshtatshme për indoktrinim dhe radikalizëm në Maqedoni

Which places / environments do you think are suitable for indoctrination and radicalization of youth?



Burimi: Hulumtimi i QHKP-së të stafi shkollor për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizmin, viti 2018

PERCEPTIMET E STAFIT SHKOLLOR PËR SHKAQET E RADIKALIZMIT

Kultura e dhunshme mashkullore, përjashtimi social dhe disponueshmëria e kufizuar e ideologjive të tjera jo të dhunshme janë arsyt kryesore se pse të rinjtë vendosin të pranojnë propagimin e ideologjisë radikale dhe përdorimin e dhunës. Kultura e dhunshme mashkullore në shoqëri kontribuon për sjelljen e dhunshme. Në fakt, arsyeja se pse njerëzit e rinj do të pranonin ideologjitë radikale, të cilat propagandojnë përdorimin e dhunës, është për shkak se *“ata besojnë se me përdorimin e dhunës do të jenë më të çmuar dhe më të respektuar nga mjedisi”* (72,62% mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme). Për këtë qëllim, presioni nga moshatarët gjithashtu krijon një vend të përshtatshëm për përdorimin e dhunës si një opsion sjelljeje. Nuk ka dallim etnik ose dallim në raport me komunën nga e cila vijjnë të anketuarit. Ajo që brengos është se përsëri shumica e të anketuarve mendojnë se *“nuk ka alternativë më të mirë (në lidhje me ideologjinë) në mjedisin në të cilin jetojnë”* (70,37% mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme) dhe prandaj të rinjtë pranojnë propagimin e ideologjisë radikale dhe përdorimin e dhunës³.

Në nivel individual, në nivelin mikro, problemet me identitetin, integrimin e pasuksesshëm, ndjenjat e përjashtimit, marginalizimit dhe diskriminimit janë arsyt kryesore se pse të rinjtë kanë tendencë të pranojnë përhapjen e ideologjive radikale dhe përdorimin e dhunës. Hulumtimi i QHKP-së tregoi se stafi shkollor beson se *pranimi i ideologjive radikale që propagandojnë përdorimin*

³ Përveç në Qytetin e Shkupit, ku me siguri ka më shumë opsione, kështu që raporti midis atyre që konsiderojnë këtë deklaratë për të rëndësishme dhe pjesërisht të rëndësishme është 61.75% në raport me 28.19%, të cilët konsiderojnë se është e parëndësishme.

e dhunës në shkollat e mesme në Maqedoninë e Veriut është rezultat i faktit se këta njerëz të rinj *“janë të dhunshëm për nga natyra dhe kërkojnë mënyra për të arsyetuar agresionin e tyre”* (përgjigjet e kombinuara nga 72,2% e të anketuarve që konsiderojnë se kjo është e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme). Një numër mjaft i madh i të punësuarve në shkollat gjithashtu besojnë se të rinjtë *“ndjehen të diskriminuar (p.sh. në bazë etnike, fetare, politike dhe sociale)”* (68,65% mendojnë se kjo është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme, ndërsa 22.82% mendojnë se kjo arsye është e parëndësishme) dhe prandaj pranojnë ideologjitë radikale. Nuk ka një dallim të rëndësishëm në raport me komunat dhe përkatësinë etnike në këtë drejtim. Pakënaqësia nga sistemi dhe nevoja për të qenë rebel dhe të ndryshohet ai, është arsyeja e tretë se pse të anketuarit mendojnë se njerëzit e rinj pranojnë ideologjitë radikale të cilat përdorin dhunë. Në fakt, 73.02% nga të anketuarit mendojnë se deklaratat: *“Ata ndiejnë se janë viktimat të padrejtësisë së sistemit dhe rebelohen për këtë shkak”* është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme. Kjo është kryesisht për shkak se ata nuk janë të integruar dhe/ose *“kanë vështirësi që të inkuadrohen në mjedisin dhe kërkojnë grupe të cilat do t'i pranojnë”* (71.97% nga të anketuarit mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme). Integrimi është më i mirë në Gostivar, ku raporti midis atyre që mendojnë se deklaratat është e rëndësishme dhe pjesërisht e rëndësishme është 59.61% në raport me ata që mendojnë se ajo është e parëndësishme (31.73%)⁴.

Duket se pranimi i ideologjive radikale është më i vogël sepse të rinjtë *“kërkojnë aventurë dhe argëtim”* (43.93% nga stafi shkollor mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme, ndërsa 37.38% mendojnë se kjo arsye është e parëndësishme). Derisa në Shkup dhe në Gostivar shifrat ndjekin trendin kombëtar, në Kumanovë dhe Tetovë raporti midis këtyre

⁴ Kjo konfirmohet përsëri me rezultatet e deklaratës *“Ata përpiqen të mbrohen nga dominimi” i shumicës në bashkësi, me atë që bëhen të ndryshëm se të tjerët!* ku raporti në Gostivar shënon 10% dallim nga pjesa tjetër e vendit ku u zbatua hulumtimi.

dy shifrave është 56% në raport me 25% dhe 34.67% në raport me 49.33%. Kjo do të thotë se në Kumanovë, ideologjitë radikale duken më tërheqëse sesa në pjesën tjetër të vendit, ndërsa në Tetovë ato janë më pak tërheqëse. Gjithashtu, hulumtimi i QHKP-së vëren edhe një dallim në raport me strukturën etnike të të anketuarve. Në fakt, 47.64% nga maqedonasit etnikë e konsiderojnë këtë arsye si shumë të rëndësishme ose pjesërisht të rëndësishme, 39.15% mendojnë se është e parëndësishme, ndërsa në pjesën shqiptare 38.58% e konsiderojnë këtë arsye si shumë të rëndësishme ose pjesërisht të rëndësishme, 37.01% e konsiderojnë si të parëndësishme. Ngjashëm me këtë, rreth gjysma e të anketuarve besojnë se të rinjtë *“janë kureshtarë për ideologjitë e ndryshme”* (49.21% mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme, kundrejt 35.06% të cilët e konsiderojnë këtë arsye si të parëndësishme) dhe prandaj janë më të hapur për t’i pranuar ideologjitë radikale dhe për ta përdorur dhunën. Një arsye tjetër është se *“ata janë në kërkim të identitetit të tyre/ndjenjës së përkatësisë”* (59.2% mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme). Përrjashtimi dhe kërkimi i identitetit personal kryesisht është i rëndësishëm në Komunën e Kumanovës, ku raporti midis këtyre dy shifrave është 78.21% kundrejt 14.85%, ndërsa rezultatet janë të ngjashme edhe për të anketuarit maqedonas edhe për të

anketuarit shqiptarë. Gjithashtu, *“kërkimi i përgjigjeve/kuptimit më të madh të religjionit dhe gjetja e tyre në grupet ekstremiste”* është e mbështetur si arsye për pranimin e ideologjisë radikale dhe përdorimin e dhunës nga ana e më shumë se gjysma e përfaqësuesve të anketuar të stafit shkollor nga ana e QHKP-së (57.08% mendojnë se ajo është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme, ndërsa 26.95% mendojnë se kjo arsye është e parëndësishme).

Në nivelin mikro, duket se ka një marrëveshje përkatëse se të rinjtë mendojnë që ideologjitë radikale dhe përdorimi i dhunës janë *“një reagim adekuat i padrejtësive të caktuara globale (konflikte, luftëra të pazgjidhura, represione të grupeve të caktuara etnike, fetare dhe politike)”* (63.42% nga stafi shkollor mendojnë se kjo arsye është shumë e rëndësishme ose pjesërisht e rëndësishme, ndërsa 21.87% mendojnë se kjo arsye është e parëndësishme). Pjesa më e madhe e komunave e ndjekin këtë trend, por në Komunën e Kumanovës korrelacioni midis këtyre dy shifrave është 76.24% kundrejt 10.89%. Kjo mund të shpjegohet me faktin se kjo komunë ishte shumë e prekur nga kriza e refugjatëve në Kosovë, konflikti ndëretnik i vitit 2001 dhe ende e jep numrin më të madh të mercenarëve të cilët punojnë në rajonet e konflikteve, siç janë Iraku, Afganistani dhe Libia. Nga ana tjetër, nuk ka dallim në trendët në nivel kombëtar dhe komunal për të anketuarit maqedonas dhe shqiptarë.

METODAT AKTUALE PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Komponenti i tretë kritik i studimit bazë është puna e vazhdueshme apo strategjitë, joformale ose formale, të cilat kanë qenë deri më tani dhe janë duke u zbatuar në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm deri më tani. Në nivel kombëtar, sipas stafit shkollor të cilin e përbëjnë të anketuarit në hulumtim, tri palët e para të prekura përgjegjëse për ndërhyrje në rastet e indoktrinimit ose radikalizmit në mesin e nxënësve janë prindërit (339 të anketuar), mësime dhënësit (203) dhe stafi për mbështetje të shkollave (148). Një përfaqësues nga Komuna e Shkupit foli për përgjigjen e zakonshme kur ka një incident të dhunshëm në një shkollë të mesme.

“Kemi shërbime komunale që merren me këto çështje. Për shembull: gjatë incidenteve fizike në autobusët e transportit publik, sidomos në numrin 65 që lëvizë drejt fshatit Stajkoc dhe hedhja e gurëve dhe rrahjet në lagjen Hasanbeg. Ne mbledhëm grupe të ndryshme prindërisht në zyrën lokale. Këto keqkuptime zakonisht zgjidhen me bisedë. Policia përfshihet si ndërmjetësues në këto situata” (Int. 11, SK).

E ngjashme me këtë, komunat, përveç Shkupit, ndjekin metodën e bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve. Komuna e Gostivarit

insiston që të gjitha lëndët të zgjidhen së pari në shkollat. Nëse shkolla nuk arrin t'i zgjidhë ato, administrata komunale e lehtëson përfshirjen e policisë dhe prindërve me qëllim që të zgjidhen problemet e filluara (Int. 6, GV).

Pastaj, aktivitetet janë ndërmarrë dhe ndërmerren në lidhje me periudhat kohore kur marrëdhëniet etnike u treguan sidomos të brishta, para se të ndodhë një incident i dhunshëm. Në komunat e Kumanovës dhe Tetovës, aktivitetet parandaluese zakonisht ndërmerren para ngjarjeve më të mëdha kolektive sportive, si dhe para fillimit të fushatave zgjedhore. E para bashkëpunon rregullisht me MPB-në (Int. 7, KU), ndërsa e dyta i organizon forumet e përbëra nga grupe përkrahësish dhe organizata rinore politike (Int. 8, TE). Kjo mund të konsiderohet si një shenjë pozitive se autoritetet në Kumanovë dhe Tetovë e kuptojnë seriozisht problemin e eksploatimit të tensioneve etnike dhe kujdesen me vëmendje lidhur me zhvillimin e tyre me kalimin e kohës. Strategjitë e këtilla sigurisht se do të kishin një vend në secilën strategji komunale, e cila do të

punojë sidomos në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut.

Megjithatë, masat parandaluese nuk janë të kufizuara vetëm në policinë dhe trupat lokale qeveritare. Udhëheqësit fetarë, po ashtu kanë zhvilluar metoda për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në kuadër të qarqeve dhe aktiviteteve fetare. Sipas një udhëheqësi fetar nga Shkupi,

“Myftinia në Shkup ndërmerr masa parandaluese para se të ndodhë një gjë e këtillë. I trajnojmë imamët në të gjitha xhamitë, në një të ardhme të afërt planifikojmë edhe një tjetër trajnim i cili do të fokusohet në mënyrat e ligjërimit dhe aftësitë komunikuese, sidomos te besimtarët e rinj. Nëse paraqiten raste të dhunës, radikalizmit ose ekstremizmit, ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me imamët dhe prindërit” (Int. 14, SK). Vërehet se parandalimi dhe ballafaqimi me rastet e ekstremizmit të dhunshëm i përfshijnë prindërit, ngjashëm me metodat që i përdor komuna. Po ashtu është e dobishme ajo që të gjithë imamët janë të trajnuar në një mënyrë të standardizuar, edhe pse nuk është e qartë për cilën lëndë konkrete të kësaj interviste. Po ashtu do të ishte e dobishme të kishim informacione të njëpasnjëshme lidhur me këtë intervistë me udhëheqësinë fetare të Shkupit që të përcaktohet nëse është mbajtur trajnimi për komunikim me të rinjtë dhe rezultatet e tija, si dhe iniciativat e ardhshme.

Lidhur me pyetjen për përfshirjen e bashkësisë fetare në proceset e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, grupi i njëjtë i të anketuarve që dha përgjigje për pyetjen paraprake për incidentet e dhunshme në shkollat, u pyet në mënyrë shtesë për mendim

lidhur me këtë pyetje: *a duhet të përfshihen bashkësitë fetare nëse dhuna zbatohet për shkak të motiveve etnike ose fetare?* Në nivel kombëtar, 21.76% janë përgjigjur se duhet të përfshihen bashkësitë fetare, ndërsa 45.61% ishin kundër kësaj ideje. Një përqindje e lartë (31.38%) e të anketuarve nuk e dinë. Është interesant fakti se një numër mjaft i vogël i të anketuarve janë për përkrahjen e bashkësive fetare që të përfshihen në këtë çështje, ndërsa pothuajse gjysma e të anketuarve ishin kundër. Rreth 77% ose nuk ishin të sigurt ose ishin kundër. Ky fakt befasues, e sidomos numri i madh i personave që kanë mbetur të pasigurt, ilustron kompleksitetin e idesë për përfshirjen e udhëheqësve fetarë në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ideja se udhëheqësit fetarë me siguri duhet të përfshihen në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, shpeshherë propozuar nga kreatorët e politikës, në fakt mund të mos përkrahet nga njerëzit. Kjo mund të ndodhë sepse ekziston potencial për një izolim të mëtejshëm të pjesëtarëve të feve të caktuara dhe për vazhdimin e stereotipave se fe të caktuara janë më shumë “të dhunshme” se të tjerat. Po ashtu, mund të vihet shumë më tepër presion mbi udhëheqësit fetarë që të përpriqen të ballafaqohen me ngjarje të cilat shpeshherë janë jashtë kontrollit të tyre. Kjo mungesë e njohurive për atë se nëse përfshirja e udhëheqësve fetarë në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, e po ashtu për kundërshtimin e shoqërisë për përfshirjen e tyre, është diçka që duhet të shqyrtohet seriozisht para se të vazhdohet me çfarëdolloj projekti dhe nëse udhëheqësit fetarë janë të përfshirë, si janë përfshirë ata dhe obligimet e tyre duhet të merren parasysh me vëmendje.

METODAT E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Komponenti i katërt i rëndësishëm i studimit bazë janë metodat të cilat përdoren për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave të lidhura me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe në lidhje me përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Një problem shpesh i vërejtur për kreatorët e politikave të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut është mungesa e të dhënave të sigurta dhe të qëndrueshme. Ky problem mund të zvogëlohet me metodat e mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve, formale dhe joformale, nga ana e të gjitha palëve të prekura në fushëveprimin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Pastaj, në bazë të këtyre informacioneve, mund të vendosen mekanizma formalë për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve në kuadër të organizatave (si shkolla, komuna, bashkësi fetare dhe administrata e pushtetit shtetëror) dhe midis palëve të interesuara nëpërmjet projekteve të njëpasnjëshme.

Sipas të anketuarve, mësimdhënësit janë, pa dyshim, pranuesit e parë të informacioneve të cilat pastaj i transferohen personelit për përkrahje. Në Shkup disa të anketuar theksuan këtë bashkëpunim në mbledhjen e informacioneve midis mësimdhënësve dhe personelit për përkrahje (Int. 1, SK, Int. 5, SK dhe Int. 6, SK). Disa shkolla në Shkup mbledhin informacione të këtilla kryesisht nga nxënësit (Int. 2, SK), duke theksuar se jo çdoherë nxënësit janë burimi më i sigurt (Int. 3, SK) sepse ata ende janë fëmijë. Këtu vlen të merret parasysh rëndësia që të mos bëhet shkolla një terren

për spiunazh, ku nxënësit e ndjejnë nevojën “për t’i denoncuar” të tjerët. Po ashtu mund të parashtrohet pyetja se nëse nxënësit e shkollave të mesme janë mjaft të pjekur që të mund të “mbledhin” informacione për nxënësit e tjerë në mënyra të sakta dhe të dobishme. Pavarësisht se nxënësit mund të inkurajohen dhe t’i drejtohen administratës për atë që ata e konsiderojnë si sjellje potenciale ekstremiste, si dhe t’i inkurajojnë mësimdhënësit që të përfshihen në jetën e nxënësve të tyre për t’i mbrojtur nga dëme, ka një rrezik që mësimdhënësit të bëhen sy dhe veshë të shtetit, e të mos e përmendim rrezikun nëse u mundësohet nxënësve të luajnë në mënyrë efikase “lojën e policisë” njëri me tjetrin. Ky është një kërcënim sidomos kur shihet mungesa e aftësisë nga ana e mësimdhënësve dhe palëve të tjera të prekura, e të mos i përmendim nxënësit e shkollave të mesme që të bëjnë një dallim midis ekstremizmit të dhunshëm dhe fenomeneve të tjera, duke përfshirë edhe vetë religjiozitetin. Për këtë shkak, përfshirja e nxënësve dhe mësimdhënësve në mbikëqyrjen e nxënësve është një çështje e ndjeshme së cilës duhet t’i qaset me një vëmendje të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh qasjen “mos bëj dëme”.

Lidhur me pyetjen për atë se si mblidhen të dhënat dhe informacionet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në kuadër të komunave, përshtypja e përgjithshme është se përfaqësuesit e komunave nuk mund të mendojnë për procesin e mbledhjes së informacioneve të lidhura me radikalizmin dhe ekstremizmin e

dhunshëm. Shumica e të anketuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje ose kanë dhënë përgjigje shumë të paqarta (Int. 8, SK, Int. 9, SK, Int. 12, SK, Int. 11, SK, Int. 6, KU dhe Int. 8, TE). Paqartësia, sidomos kur bëhet fjalë për ekstremizmin e dhunshëm, është e rrezikshme. Ka rrezik, siç u diskutua paraprakisht, që fenomene të ndryshme të përputhen së bashku dhe të gjeneralizohen. Për shembull: nëse incidentet në kuadër të komunave ose ekstremizmi nuk evidentohen vazhdimisht me kalimin e kohës (përkatesisht raportim për numrin, karakterin dhe nivelin e incidenteve të dhunshme dhe retorikën ekstremiste), do të jetë shumë e vështirë të bëhet një analizë e atyre të dhënave dhe të shihet nëse intervenimet kanë efekt. Kjo do të thotë po ashtu se ndoshta nuk ndërmerren aktivitete konkrete lidhur me mbledhjen e të dhënave, ndërsa i anketuari vetëm shkon drejt asaj që e konsideron si “përgjigje të saktë”. Megjithatë, duhet të merret parasysh se puna lidhur me politikën kundër ekstremizmit të dhunshëm sapo ka filluar në vend dhe paqartësia mund të dalë nga niveli i ulët i njohurive dhe vetëdijes për politikën kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe mungesa e një sistemi të reagimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Që nga miratimi i Strategjisë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në shkurt 2018, komunat janë gjithashtu të përgjegjshme për të kontribuar ndaj sistemit të reagimit institucional ndaj kësaj dukurie. Autoritetet komunale janë të obliguara që të përgatisin plane aksionare lokale dhe së bashku me ekipet aksionare lokale të kontribuojnë për zbatimin e Strategjisë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, gjetjet e hulumtimit të QHKP-së tregojnë se komunat janë shumë pak të vetëdijshme për rolin e tyre në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për më tepër, as strategjia e as komunat, siç vërehet në hulumtim, nuk janë të vetëdijshme për përgjegjësinë për mbledhjen e të dhënave lidhur me ekstremizmin e dhunshëm. Për këtë qëllim, projekti duhet të rrisë njohuritë dhe vetëdijen e palëve të prekura komunale për Strategjinë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të diskutohet për nevojat dhe përgjigjet përkatëse

për nevojat e komunës, të cilat do të çojnë në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe mundësitë secila komunë të kontribuojë për zbatimin e Strategjisë. Pastaj, duhet të përmirësohen kapacitetet e komunave që të mund të kenë një rol më aktiv në sistemin e reagimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm, por gjithashtu të ndjekin dhe të njoftojnë për numrin, karakterin dhe nivelin e incidenteve të dhunshme dhe retorikën ekstremiste të cilën e përdorin më shumë palë të prekura në komunitet. Do të ishte e rëndësishme vendosja e një sistemi për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave në nivel lokal, si dhe për raportim të rregullt dhe analizë të trendeve në nivel kombëtar. Për këtë qëllim, e me qëllim që reagimi ndaj ekstremizmit të dhunshëm të jetë efektiv, është e rëndësishme që të vendoset një lidhje midis organeve në nivel lokal të cilat punojnë në luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe Komitetit kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Kjo në mënyrë të pashmangshme do ta përmirësojë situatën e zbuluar, ku pavendosmëria e komunave në lidhje me mbledhjen e informacioneve nga ana e tyre për ekstremizmin e dhunshëm konsiderohet si problematik sepse ata janë një pjesë e rëndësishme në makinën e tërësishme të ndjekjes dhe punës policore për ekstremizmin e dhunshëm në një komunë të caktuar. Kjo paqartësi në bordin e komunave do të mund të ishte një dobësi për zbatimin e tërësishëm të Strategjisë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal.

Nga ana tjetër, zyrtarët e MPB-së, duke bashkëpunuar me këshillat lokale për parandalim (LCPs), emëruan burime të shumëfishta informacionesh. Bashkëbiseduesi nga Shkupi theksoi se kohët e fundit policia mbështetet kryesisht në mediat sociale si burim kryesor i informacioneve:

“Kohët e fundit, burimi ynë kryesor i informacioneve për këto çështje është interneti, sidomos mediat sociale. U bashkëngjitemi grupeve të shumta dhe u vëmë “like” faqeve të shumta në Facebook që të mbetemi të informuar. Si burime të tjera më pak të rëndësishme të informacioneve do t’i përmendja edhe kolegët, kalimtarët e rastit etj.”(Int. 13, SK).

Një shenjë pozitive është se Ministria e Punëve të Brendshme e njej shkalën e përdorimit të mediave sociale në propagimin e ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa ndjekja e atyre prezencave on-line u mundëson personave zyrtarë të shikojnë përmbajtjet dhe të shikojnë interaksionet publike, që mund të ndihmojë që të përcaktohet se si mund të ndodhë procesi i radikalizmit. Do të ishte e dobishme pastaj të dihet se si i përdorin ata mediat sociale dhe komunikojnë me to në ndjekjen e tyre, si dhe cilat informacione i sigurojnë nga kolegët e tyre dhe nga “kalimtarët e rastit” dhe si përdoren ato informacione.

Kategoria e fundit e të anketuarve, udhëheqësit fetarë, ishin mjaft laik kur u pyetën për mjetet e marrjes së informacioneve të lidhura me radikalizmin dhe ekstremizmin. Të gjithë përfaqësuesit religjiozë, me përjashtim të myftinjve në Shkup, nuk arritën të sigurojnë informacione ose dhanë përgjigje të pasakta. Kjo mungesë aftësie të udhëheqësve fetarë për të dhënë përgjigje është potencialisht problematike. E ngjashme me përfaqësuesit e komunave, duket se nuk ka një mekanizëm formal për mbledhjen e informacioneve, përveç metodave joformale. Sepse xhamitë janë më afër njerëzve lidhur me mendimin religjioz dhe janë pjesërisht të afta që kontrollojnë narrativë ose grupe të ndryshme në institucionin e tyre, brengos fakti që del se tek ato nuk janë vendosur mekanizma për mbledhjen e informacioneve. Myftiu nga Shkupi theksoi rrjetin formal të imamëve dhe xhamive nën kompetencën e tij si burim primar i informacioneve. Të gjitha palët e tjera të prekura zakonisht shpërndajnë informacionet me imamët të cilët pastaj përhapin informacionet nëpërmjet hierarkisë vertikale:

“Ne mbledhim informacione nga më shumë burime. Duke pasur parasysh se kemi imamë në më shumë se 130 xhami në territorin e Shkupit, çdo ditë kemi kontakte edhe me imamët edhe me ‘komitetet e xhamive’. Në atë mënyrë, kemi informacione të drejtpërdrejta për ngjarjet në të gjitha xhamitë. Nëse paraqitet diçka të pazakonshme, ajo e tërheq vëmendjen tonë të drejtpërdrejtë dhe të tërësishme. Ne, gjithashtu mbledhim informacione nga prindërit sepse kur vërejnë diçka të pazakonshme te

fëmijët e tyre, ata kërkojnë ndihmë nga imamët. Këto raste nuk janë shumë të shpeshta, por megjithatë ndodhin”. (Int. 14, SK).

Këto metoda për mbledhjen e informacioneve të përshkruara nga ana e myftinjve të Shkupit duket se, edhe pse janë të dobishme, nuk janë të standardizuara dhe të pranishme në të gjitha xhamitë në vend. Ajo që do të ishte mjaft e dobishme është që të formohet një rrjet formal i imamëve të xhamive nën udhëheqjen e myftinjve dhe komiteteve të xhamive (do të ishte e dobishme të kontrollohet puna e komiteteve të xhamisë dhe të përcaktohet se si mund të përfshihen ato). Standardizimi i kësaj praktike nëpër gjithë bashkësinë fetare, pa dallim të cila fe, me siguri do të sillte rezultate. Pastaj, edhe pse metodat e mbledhjes së informacioneve që i parasheh myftiu i Shkupit mund të sigurojnë një plan për bashkësitë e tjera fetare në vend në lidhje me rregullimin e çështjeve në bashkësinë përmes komisioneve, metodat e tjera duken mjaft ad-hok. Do të ishte e dobishme të aplikohet një metodë më zyrtare dhe të rregullt për mbikëqyrje. Këtë qasje më ad-hok të mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve e përshkroi gjithashtu zyrtari i Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Shkupi në një deklaratë në të cilën theksohet mungesa e veçantisë së sjelljes kur bëhet fjalë për shkëmbimin e informacioneve midis policisë dhe palëve të tjera të prekura dhe ai zyrtar theksoi në mënyrë shtesë nevojën e komunikimit të tillë:

“Policia ka kontakte me të gjitha palët e prekura lokale, por jo në raport me dhunën, radikalizmin dhe ekstremizmin. Në disa pjesë të Qytetit të Shkupit ka një nevojë të fortë për vendosjen e këtyre mekanizmave: Gjorçe Petrovi, Saraji, Gazi Baba, Çairi dhe Bit Pazari do të ishin vatrë në Qytetin e Shkupit” (Int. 13, SK).

Të gjithë udhëheqësit e intervistuar fetarë përfunduan se nuk ekzistojnë mekanizma të vendosur formalë në lidhje me shkëmbimin e informacioneve dhe mbledhjen e të dhënave. Dy bashkëbisedues e përkrahën veçanërisht nevojën për vendosjen e tyre (Int. 7, TE dhe Int. 2, TE dhe GV).

RESURSET DHE INICIATIVAT E NEVOJSHME PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT NË SHKOLLAT

Elementi i fundit që duhet të hulumtohet për studimin bazë të palëve të involvuara për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm është ajo që e kanë identifikuar ato në intervistat si të domosdoshme për to me qëllim që të kryejnë punën e tyre në mënyrë më përkatëse, për cilat resurse ose për cilën përkrahje kanë nevojë ata dhe kush duhet të përfshihet në përpjekjet e tyre në të ardhmen. Për këtë qëllim, në pjesën që vijon është dhënë një analizë e vlerësimit të nevojave të trajnimit, e cila ishte një pjesë përbërëse e hulumtimit të QHKP-së. Elementi kryesor i cili u identifikua nga stafi shkollor ishte nevoja për arsimim dhe trajnim të mëtijshëm kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në fakt, stafi arsimor ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve në bazë të fenomeneve dhe faktorëve që ndikojnë ndaj paraqitjes së radikalizmit, si dhe shenjat e zbulimit të radikalizmit në shkolla. Është interesante se nevojat për ngritjen e kapaciteteve për temat që lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në bazat e ekstremizmit të dhunshëm, identifikimin e retorikës ekstremiste, tolerancën etnike/fetare dhe protokollet që duhet të ndiqen në rastet e zbulimit të ekstremizmit të dhunshëm, janë identifikuar jo vetëm për stafin shkollor, por edhe për nxënësit dhe për administratën komunale.

Për shembull: stafi shkollor u pyet se *cilat tema duhet të përfshihen në programin mësimor për shkollat e mesme me qëllim që të përmirësohet procesi i parandalimit të radikalizmit të nxënësve*. U prezantuan këto tema: bazat e radikalizmit, ekstremizmi i dhunshëm dhe parandalimi; toleranca etnike; toleranca religjioze; identifikimi i gjuhës së urrejtjes; identifikimi i propagandës ekstremiste; zgjidhja e konflikteve; stereotipat dhe konfliktet dhe ndikimi i tyre dhe mendimi kritik. Të anketuarit po ashtu kishin hapësirë për të sugjeruar edhe tema të tjera. Duke i shikuar preferencat në nivel kombëtar, 303 mësimdhënës u vendosën për temën toleranca etnike, ndërsa toleranca fetare u përmend 252 herë, pas të cilave vijonte tema zgjidhja e konflikteve (223). Bazat e radikalizmit, ekstremizmi i dhunshëm dhe parandalimi u përmendën 206 herë, ndërsa stereotipat dhe konfliktet dhe ndikimi i tyre ishte zgjedhja e 178 të anketuarve. Është e qartë se spektri i gjerë i temave për pyetjet relevante lokale, siç janë këto, duhet të shtohen në programin shkollor të mësimi me qëllim që të edukohen nxënësit për çështje me të cilat me siguri do të ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme lidhur me ekstremizmin e dhunshëm. Temat pastaj kanë të bëjnë me pyetje të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe shumë tema të tjera të rëndësishme në shoqërinë e Maqedonisë,

siç janë mendimi kritik dhe zgjidhja e konflikteve. Duket se temat më të nevojshme janë toleranca etnike dhe fetare.

Stafi shkollor theksoi gjithashtu se cilat gjëra jashtë programit shkollor do të jenë të nevojshme që të mbështetet në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në mesin e popullatës studentore. Derisa pjesa më e madhe e të anketuarve komentonin se në shkollat ku punojnë nuk ka procese [të radikalizmit], disa komente tregojnë se ky problem nuk merret shumë seriozisht siç duhet dhe se stafi shkollor duhet të jetë i trajnuar dhe të përfshihet më shumë në ndjekjen e këtyre dukurive. Këta të anketuar theksojnë nevojën për më shumë të punësuar për mbështetje të stafit të shkollave, siç janë: psikologët, pedagogët dhe sociologët, të cilët do të punojnë me ta dhe do t'i ndjekin me vëmendje rastet e nxënësve që janë të prirur ndaj radikalizmit. Është interesante të theksohet se shumica e stafit shkollor insistojnë se në shkollat e tyre nuk ka procese të radikalizmit, por megjithatë pretendojnë se problemi nuk merret seriozisht sa duhet dhe se duhet të përfshihen më shumë njerëz për parandalimin e tij. Ndoshta ata identifikojnë disa shenja potenciale të radikalizmit ose dëshirojnë që shkolla të angazhohet më shumë në parandalimin e tij. Gjithashtu, është një shenjë pozitive të theksohet se shumica nuk i kanë parë proceset e drejtpërdrejta të radikalizmit në shkollat e tyre.

Statistikat pajtohen me mendimin e punëtorëve shkollorë që është dhënë më lart se stafi shkollor duhet të përfshihet dhe të trajnohet më shumë për ndjekjen e incidenteve të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm. Sa i përket pyetjes *nëse në pesë vitet e fundit ata kanë marrë pjesë në çfarëdo trajnimesh të lidhura me integrimin ndëretnik, zgjidhjen e konflikteve, parandalimin e sjelljes së dhunshme dhe/ose devijuese të nxënësve, njohjen me proceset e indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve ose trajnime të ngjashme*, 78.18% kanë dhënë përgjigje negative, ndërsa 21.61% e kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre. Trendët janë të ngjashëm edhe në nivel etnik, por pothuajse dy herë më shumë maqedonas janë të trajnuar në krahasim me shqiptarët: 28.78 kundrejt 14.64%. Në nivel komunal,

shifrat kryesisht përputhen me ato të nivelit kombëtar. Është kryesore, sipas stafit shkollor, të rritet numri i stafit shkollor i cili është i trajnuar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm/çështjet etnike/zgjidhjen e konflikteve, e sidomos në mesin e shqiptarëve etnikë, ku numri i atyre që kanë marrë pjesë në trajnime të këtilla është dukshëm më i ulët se përqindja kombëtare. Pastaj, është interesante të theksohet se edhe pse trajnimet për këto tema janë zakonisht ndër pjesët më shpesh të përmendura të domosdoshme dhe kryesore të punës që lidhet me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në shkollat, duket se është e saktë që problemi me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nuk merret shumë seriozisht në sferën e arsimit.

Stafi shkollor pastaj sugjeron ide të lidhura me punëtorin të cilat do të mund të mbaheshin në lidhje me ekstremizmin. Shumica më e madhe shprehu nevojën për një qasje sistemore për mbajtjen e punëtorëve për ekstremizëm dhe radikalizim. Përveç kësaj, propozime të tjera përfshijnë punëtorin për: zgjidhjen e konflikteve, integrimin multi-etnik, tolerancën, devijimin, ndërmjetësimin, inteligjencën emocionale dhe bashkëjetesën. Produkti kryesor nga këto njohuri është, sipas mendimit tonë, nevoja për një qasje *sistemore* e cila zbatohet në mënyrë universale, kundrejt metodës ad-hok, e cila dukej se dominonte në ngjarjet e deritanishme.

Në vazhdim të intervistave të detajuara, të gjitha katër kategoritë e të anketuarve u pyetën se *çfarë u mungon institucioneve me qëllim që të parandalohe më mirë rastet e dhunës, radikalizmit dhe ekstremizmit*. Stafi shkollor në përgjithësi komenton se kanë nevojë për më shumë trajnime dhe seminare, në përputhje me konstatimin e lartpërmendur dominues, si dhe mjete për projekte të cilat pastaj do t'i angazhojnë nxënësit. Kjo tregon dy gjëra: duhet të ketë resurse (edhe financiare edhe arsimore) të cilat mund t'i përdorin mësimdhënësit për t'i angazhuar nxënësit në këto tema dhe se mësimdhënësit dëshirojnë të jenë të angazhuar në mënyrë më sistemore në këtë temë me nxënësit e tyre. Ata kanë nevojë për ndihmë për ta zbatuar atë.

Kjo ndjenjë për një angazhim sistemor, siç u theksua më lart, në vend të mekanizmave ad-hok dhe joformale për reagim, u përsërit në mënyrë shtesë nga ana e mësimdhënësve. Një mësimdhënës përmendi nevojën e protokolleve për një aktivitet të mëtijshëm nëse mësimdhënësi zbulon dhunë, sjellje radikale ose ekstremiste (Int. 1, GV), ndërsa një mësimdhënës tjetër i intervistuar theksoi nevojën për të pajisur stafin e shkollës për përkrahje, si dhe për mjete shtesë financiare në përgjithësi (Int. 2, GV) që pasqyron ndjenjën e përgjithshme për resurset e të punësuarve që u shpreh nga ana e stafit shkollor.

Sa i përket palëve të ndryshme të prekura të cilat të anketuarit mendojnë se duhet të angazhohen më shumë në proceset e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në shoqëri, një nga të anketuarit theksoi dy palë të prekura kryesore që duhet të angazhohen: familja, si thelbi i shoqërisë, dhe shkollat – të cilat duhet të krijojnë trupa për ndërmjetësim që do t'i ndjekin me vëmendje këto çështje (Int. 4, SK). Ky i anketuar nxiti ndërmjetësim nga ana e shkollës, që tashmë zbatohej në disa shkolla, siç u theksua më lart dhe sipas tij, do të ishte e dobishme që të standardizohet ndërmjetësimi i këtillë nga ana e shkollës në programin kombëtar. Pastaj të anketuarit u pyetën për t'u dhënë prioritet palëve të prekura të cilat duhet të intervenojnë nëse vërejnë te nxënësit çfarëdolloj shenjash të radikalizmit ose indoktrinimit. Në nivel kombëtar, tri palët e para të prekura, të cilat i kanë identifikuar të anketuarit, ishin prindërit (339), mësimdhënësit (203) dhe stafi i shkollave për përkrahje (148), kështu që nuk ka dallime të rëndësishme në përgjigjet midis shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë. Ata gjithashtu u pyetën se cila, sipas përvojës së tyre, është metoda më e shpeshtë për t'u përgjigjur incidenteve të dhunshme te nxënësit në shkollat e tyre, kështu që 38% janë përgjigjur se metoda më tipike është thirrja e prindit të nxënësit, 32% kanë deklaruar se e kanë dërguar nxënësin te psikologu ose pedagogu i shkollës, ndërsa 27% kanë deklaruar se metoda më e shpeshtë është disiplinimi i nxënësit nga ana e drejtorit të shkollës.

Një nga të anketuarit nga Tetova e theksoi rolin e mediave, internetit dhe partive politike për ngritjen e alarmit me zë të lartë lidhur me çështjet e diskutuara (Int. 6, TE). Mund të jetë e dobishme nëse përfshihen të gjitha palët e prekura që kanë ndikim në mediat (mediat sociale, rrjetet e lajmeve dhe mediat tradicionale) që të ngrihet vetëdija për këtë çështje, si dhe strategjitë kombëtare për të parandaluar atë. Bashkëbiseduesit nga Gostivari besojnë në një bashkëpunim më të fortë midis pushtetit qendror dhe atij lokal (Int. 1, GV dhe Int. 3, GV), por gjithashtu edhe në përfshirjen e palëve të tjera të prekura, siç janë: mësimdhënësit, stafi shkollor për përkrahje dhe policia (Int. 2, GV), duke kujtuar kështu për idenë e standardizimit të protokolleve të medimit në shkollat dhe përfshirjen e të gjithëve në programet kombëtare me aktivitete të ndryshme të zbatuara nga secili nxënës.

Megjithatë, lidhur me aktorin kryesor i cili duhet të ndërmarrë përgjegjësinë për të reaguar ndaj këtij fenomeni, për fat të keq, përfaqësuesit qeveritarë ishin mjaft të paqartë, shumë më pak se punëtorët e shkollave. Përfaqësuesit e komunave nuk ishin aq refleksivë sikurse stafi shkollor lidhur me çështjen se cilat duhet të jenë palët e prekura kryesore në bashkësitë lokale për ndërmarrjen e aktiviteteve për zgjidhjen e incidenteve të dhunës, radikalizmit dhe ekstremizmit. Gjysma e përfaqësuesve të komunës nuk kishin mundësi të sigurojnë një përgjigje të saktë për pyetjen (Int. 8, SK, Int. 11, SK, Int. 12, SK dhe Int. 6, KU). Një bashkëbisedues nga një komunë në Shkup fliste për nevojën e përfshirjes gjithëpërfshirëse të të gjitha institucioneve shtetërore (Int. 10, SK), (faqe 39), por kjo është tërësisht e paqartë dhe nuk e delegon përgjegjësinë askund në veçanti.

Nga ana tjetër, lidhur me çështjen e njëjtë për atë se kush nga palët e interesuara kryesore duhet të obligohet për t'u përgjigjur këtij fenomeni, funksionarët e MPB-së, të cilat kanë një bashkëpunim të ngushtë me këshillat lokale të parandalimit (LCPs), u përcaktuan për një qasje më integruese, duke përfshirë sa më shumë palë të prekura në procesin e parandalimit të dhunës, radikalizmit dhe

esktrmizmit në nivelin e komunitetit. Bashkëbiseduesi ynë nga Shkupi përkujtoi për praktikën e mirë të njëres prej komunave në fushën e tij të punës:

“Një shembull i mirë është Komuna e Kisella Vodës me Qendrën për parandalimin dhe trajtimin e varësisë nga droga, e cila është e mbushur me pacientë. Është formuar një trup koordinues nga ekspertë dhe qytetarë nga më shumë sfera. Megjithatë, institucionet duhet t'i rrisin nivelet e tyre të specializimit dhe të njohurive për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm”. (Int. 13, SK).

Ky shembull tregon një hap pozitiv që mund të transferohet ndoshta në nivel kombëtar (trup koordinues nga ekspertë nga më shumë sfera), të cilat reagojnë së bashku ndaj një dukurie komplekse. Megjithatë, kjo tregon po ashtu se edhe pse duhet të inkurajohet bashkëpunimi, duhet të ekzistojnë persona të caktuar, përgjegjësia kryesore e të cilëve është parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm. Kjo tregon se duhet të ekzistojnë individë konkretë të obliguar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, njëkohësisht me përfshirjen e mendimeve dhe ekspertizës të të gjithë palëve të involvuar, puna e të cilave është në kontakt me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Kjo do të sigurojë një gamë të gjerë aktiviteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, por edhe njohuri specifike të nevojshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm për çdo sferë që është në kontakt me të (arsimi, institucionet fetare, pushteti lokal).

Kategoria e fundit e të anketuarve, udhëheqësit lokalë fetarë, dhanë përgjigje të ndryshme lidhur me palët e prekura kryesore në nivel lokal, të cilat duhet të luajnë rolin kryesor në parandalimin e dhunës, radikalizmit dhe ekstremizmit. Një udhëheqës fetar nga Gostivari beson se duhet të angazhohen të gjitha institucionet kompetente, por në radhë të parë shkollat dhe komunat (Int. 5, GV). Kolegu i tij nga Tetova beson se rolin kryesor e ka shteti, e pastaj vijnë komunat, shkollat dhe të gjitha palët e tjera të prekura (Int. 7, TE). Një çështje interesante që duhet të hulumtohet në raport me

modelin e Kisella Vodës nga lart është se nëse pushteti qendror dhe më i lartë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duhet të jetë shteti, ndërsa të gjitha palët e tjera të prekura t'i ndërmarrin urdhrat e tyre nga shteti ose nëse trupi për bashkëpunim do të ishte organi më i lartë i vendimmarrjes në lidhje me politikën dhe aktivitetet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Pyetja për këtë çështje duhet të hulumtohet me hulumtime për shqyrtimin e praktikave më të mira nga vendet e tjera.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Kjo pjesë i jep konkluzionet e gjetjeve të studimit bazë. Në të njëjtën kohë, ajo i definon rekomandimet specifike në bazë të rezultateve të hulumtimit që t'i zbatojë ekipi i projektit. Duke e pasur parasysh krijimin e projektit, rekomandimet janë relevante për pakon e dytë dhe të tretë të punës: (I) ngritja e kapaciteteve dhe (II) sistemi komunal i parandalimit.

KONKLuzionet

Perceptimi i stafit shkollor ishte se Shkupi është shtëpia e më shumë individëve që janë radikalizuar, e po ashtu edhe perceptimet për incidentet e dhunshme në shkollat ishin dukshëm më të larta në Shkup sesa në vendet e tjera në Maqedoninë e Veriut. Këto perceptime shënojnë përshtypjen e përgjithshme të të anketuarve se Shkupi është shumë më i prekur nga radikalizmi dhe/ose ekstremizmi i dhunshëm se vendet e tjera në Maqedoninë e Veriut.

Përgjigjet dhe perceptimet e përfaqësuesve të komunave dallohen në masë të madhe se përgjigjet e mësimdhënësve dhe

përfaqësuesve të tjerë të stafit shkollor, sidomos në raport me perceptimet e ndryshme për atë se nëse kohët e fundit ka pasur incidente të dhunshme midis nxënësve në shkollat. Perceptimet e ndryshme të përfaqësuesve të komunës se ato të mësimdhënësve mund të sugjerojnë se ka një ndërprerje të komunikimit midis stafit shkollor dhe nëpunësve komunalë në përgjithësi, e po ashtu huton kreatorin e politikës për atë se nëse incidentet në fakt reduktohen ose jo dhe në këtë mënyrë krijohen konfuzione gjatë përcaktimit të asaj se cilat politika funksionojnë dhe në cilin kontekst. Pastaj, sugjeron se sipas rolit që e luajnë në orbitën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, organizatat e ndryshme mund të kenë perspektiva dhe interesa të ndryshme ose të kenë qasje deri në informacione të ndryshme, dhe prandaj mund të kenë perceptime të ndryshme ose madje edhe të kundërta për dukuritë e njëjta.

Ka një mungesë të konsiderueshme të vetëdijes dhe kuptimit të strategjive kombëtare për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut dhe planeve të saja aksionare. Vetëm përfaqësuesit e stafit shkollor të cilët kanë marrë pjesë në trajnimin e OSBE-së për luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm kanë dëgjuar për to, por askush nga të tjerët. Këto strategji duhet të luajnë rolin qendror në trajnimet e ardhshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa Komiteti kombëtar, po ashtu, duhet të ketë një rol në krijimin/organizimin e trajnimeve. Gjithashtu ekziston nevojë për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me gatishmërinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe për faktet e tija themelore, si dhe për prodhimin e materialeve në të cilat stafi shkollor mund të mbështetet për protokolle gjatë incidenteve të dhunshme ekstremiste në shkollat.

Përgjigjet dhe protokollet, siç është monitorimi i fushatës parazgjedhore që e kanë zbatuar komunat e Kumanovës dhe Tetovës, si dhe protokollet e bashkësisë fetare që përdoren në Myftininë e Shkupit, duhet të standardizohen dhe të përdoren në nivel kombëtar me qëllim që të sigurohen aktivitete parandaluese të lidhura me problemet që janë identifikuar në trendet e kaluara dhe të

kenë përgjigje të organizuara dhe gjithëpërfshirëse nga të gjitha palët e involvuara.

Në kundërshtim me atë që duket se është normë për projektet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, shumica e madhe e të anketuarve thanë se udhëheqësit fetarë ose nuk duhet të përfshihen në aktivitetet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm ose se nuk janë të sigurt për atë se cili duhet të jetë roli i udhëheqësve fetarë. Ky është një konstatim jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse është në kundërshtim me atë që perceptohet në përgjithësi lidhur me përfshirjen e udhëheqësve fetarë në përpjekjet e lidhura me incidentet e dhunshme (IDH). Ky konstatim, po ashtu, mund ta tregojë nevojën për vetëdije për rolin të cilin mund ta kenë udhëheqësit fetarë në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Kjo është shumë e rëndësishme sepse në nivel kombëtar, stafi shkollor në shkollat i theksonte institucionet fetare dhe shkollat fetare (46.73%) si një vend i përshtatshëm për indoktrinim dhe radikalizëm. Po ashtu, duke e marrë parasysh se asnjë nga projektet aktuale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nuk trajton internetin dhe mediat sociale, studimi ofron një konstatim të rëndësishëm se ato janë vendi më i përshtatshëm për indoktrinim dhe radikalizëm (70.89%). Prandaj, rekomandohet seriozisht që t'u drejtohet vëmendja aktiviteteve të lidhura me përdorimin e internetit dhe sigurimin e internetit në përpjekjet e ardhshme për parandalimin e radikalizmit. Puna me grupet e ngjashme (31.09%) gjithashtu duhet të jetë një prioritet për kreatorët e politikave të cilët planifikojnë aktivitetet e parandalimit.

Kur bëhet fjalë për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve nga të anketuarit, është e qartë se mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm kur bëhet fjalë për radikalizmin potencial të nxënësve, por edhe nga vetë studentët nuk duhet të pritët të sigurohen informacione për njëri-tjetrin. Nga biseda me përfaqësuesit e komunave dhe udhëheqësit fetarë, megjithatë, ishte e qartë se nuk ka mekanizma formale ose zyrtare për mbledhjen e të dhënave. Me rëndësi shumë të madhe do të ishte që për këto dy grupe të

sigurohet një trajnim për atë se cilat të dhëna duhet të mblidhen dhe si duhet të mblidhen dhe për atë se në cilën mënyrë mund të analizohen ato të dhëna. Ministria e Punëve të Brendshme ishte pak më konkrete kur i lidhi përpjekjet e saja të monitorimit me Facebook-un, por, gjithashtu mungonte një konkretësi lidhur me këto aktivitete për monitorim. Prandaj, do të ishte e mençur që të përfshihen zyrtarët e MPB-së në trajnimin për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve. Të gjithë të anketuarit theksuan nevojën e aplikimit të temave të tolerancës etnike dhe fetare në programin kombëtar të mësimin për arsim të mesëm, përveç temës zgjidhja e konflikteve dhe bazat e radikalizmit. Staf shkollor e theksoi nevojën për trajnime për atë se si të ballafaqohen dhe t'i përgjigjen këtij fenomeni, ndërsa shumica dërmuese në pesë vitet e kaluara nuk kanë marrë pjesë në një trajnim të lidhur me integrimin etnik, ekstremizmin e dhunshëm ose një temë të ngjashme. Ata sugjerorin tema të mundshme për trajnimet, duke i përfshirë edhe tolerancën ndëretnike dhe zgjidhjen e konflikteve. Ata gjithashtu e theksuan nevojën e madhe për një qasje sistematike e cila zbatohet në mënyrë universale lidhur me mbajtjen e këtyre trajnimeve për stafin shkollor, kundrejt metodave kryesisht ad-hok të cilat zbatoheshin deri më tani. Mësimdhënësit gjithashtu insistonin për nevojën e përdorimit të një protokollit nëse vërehen shenja të radikalizmit, si dhe për resurset arsimore dhe financiare që të ballafaqohen me ekstremizmin e dhunshëm në përgjithësi. Programi për trajnim, i cili është planifikuar si pjesë e projektit të lidhur me këtë raport, do të krijojë tri module për trajnim në bazë të nevojave të identifikuar, materialeve të trajnimit dhe veglave të zbulimit, duke i përfshirë listat kontrolluese dhe protokollet. Temat e programit të trajnimit do të përfshijnë informacionet themelore për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin, zhvillimin e metodave të parandalimit të radikalizmit të nxënësit dhe përcaktimin e sistemit të përkrahjes në nivel të shkollës, në nivel komunal dhe kombëtar.

Pyetja e përgjegjësisë për problemin e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm nuk mori përgjigje të qarta nga ana e

përfaqësuesve të komunave, ndërsa bashkëpunimi midis autoriteteve kombëtare dhe lokale në koordinim me shkollat u identifikuan nga ana e stafit shkollor si faktorë kryesorë të cilët duhet të ndërmarin përgjegjësinë për këtë çështje. Së bashku me rekomandimet e cekura më lart, pohojmë se duhet të ketë një sistem të qartë dhe të standardizuar të komandës, i cili “posedon” çështjen për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe i cili drejton palët e tjera të prekura në rolet e tyre, duke theksuar njëkohësisht rëndësinë e çdo nxënësi.

REKOMANDIMET

NGRITJA E KAPACITETEVE PËR ZBULIMIN E RADIKALIZMIT QË ÇON NË EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM M

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të stafit shkollor, por gjithashtu edhe të nxënësve për bazat e ekstremizmit të dhunshëm, identifikimi i retorikës ekstremiste, tolerancës etnike/fetare, shenjave të zbulimit të radikalizmit dhe protokolleve që duhet të ndiqen në rastet e ekstremizmit të dhunshëm;
- ✓ Të zhvillohet një program për trajnim që do t'i përmbajë këto tema: bazat e radikalizmit, ekstremizmi i dhunshëm dhe parandalimi; toleranca etnike, toleranca religjioze; identifikimi i gjuhës së urrejtjes; identifikimi i propagandës ekstremiste; zgjidhja e konflikteve; stereotipat dhe konfliktet dhe ndikimi i tyre dhe mendimi kritik;
- ✓ Të zhvillohen vegla për zbulimin dhe përkrahjen e stafit shkollor, me të cilat identifikohen disa shenja potenciale të radikalizmit ose dëshira që shkolla të angazhohet më shumë në parandalim;

- ✓ Të zhvillohen protokolle (dhe lista të kontrollit) për mësimdhënësit, psikologët dhe pedagogët për zbulimin e sjelljes së dhunshme, radikale ose ekstremiste në klasë dhe menaxhimi i procesit shkollor në parandalimin e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm;
- ✓ Institucionalizimi i programit për ngritjen e kapaciteteve të arsimit sepse mësimdhënësit kanë nevojë për një qasje sistematike për fitimin e njohurive dhe aftësive për ekstremizmin dhe radikalizmin, por edhe për zgjidhjen e konflikteve, integrimin multietnike, tolerancën, devijimin, ndërmjetësimin, inteligjencën emocionale dhe bashkëjetesën. Integroni këto tema në programin e mësimi për mësimdhënësit.

SISTEMI KOMUNAL PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT QË ÇON NË EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

- ✓ Të rriten njohuritë dhe vetëdija te palët e prekura komunale për Strategjinë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- ✓ Përforcimi i dialogut në nivel lokal me qëllim që të bisedohet për nevojat dhe përgjigjet përkatëse të nevojave të komunës që do të çojë në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe mundësitë që secila komunë të kontribuojë për zbatimin e Strategjisë;
- ✓ Duhet të krijohen mekanizma më të mirë të komunikimit për incidentet e dhunshme në shkollat, me një komunikim të drejtpërdrejtë dhe të rregullt midis shkollave dhe zyrtarëve komunalë;
- ✓ Të zhvillohet një model komunikues për sistemin e udhëzimit, specifik për kapacitetin komunal, që do të bazohet në qasjen

e tërësishme të shoqërisë për angazhimin e të gjitha palëve të prekura relevante në nivel lokal;

- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve të komunave për të pasur një rol aktiv në sistemin e reagimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm, por gjithashtu të ndjekin dhe të raportojnë për numrin, karakterin dhe nivelin e incidenteve të dhunshme dhe të retorikës ekstremiste të cilën e përdorin më shumë palë të prekura në komunitet;
- ✓ Krijimi i një sistemi për mbledhjen e të dhënave dhe për mbajtjen e të dhënave në nivel lokal, si dhe për raportim të rregullt dhe analizë të trendëve në nivel kombëtar;
- ✓ Të vendoset një lidhje midis organeve në nivel lokal të cilat punojnë në luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe Komitetit kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- ✓ Është identifikuar një kapacitet i ngritur i administratës komunale për bazat e ekstremizmit të dhunshëm, identifikimin e retorikës ekstremiste, tolerancën etnike/fetare, shenjat e zbulimit të radikalizmit dhe protokollet e ndjekjes në raste të ekstremizmit të dhunshëm;
- ✓ Siguroni resurse (financiare dhe arsimore) të cilat mund t'i përdorin mësimdhënësit që t'i angazhojnë nxënësit për temat e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit;
- ✓ Sepse mësimdhënësit dëshirojnë të përfshihen në mënyrë më sistematike në këtë temë me nxënësit e tyre, të gjitha programet shkollore duhet të përfshihen aktivitete për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizëm. Këshilli komunal miraton programin shkollor dhe prandaj në nivel komunal duhet të ketë një mekanizëm për t'u kontrolluar nëse programi shkollor përfshin aktivitete të lidhura me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmin.

VLERËSIMI I PROJEKTIT

Në bazë të gjetjeve të këtij studimi, këto rekomandime për inter-venime/plotësime të detajuara të aktiviteteve të projekteve dërgohen deri te ekipi i projektit. Tabela më poshtë gjithashtu ofron propozime të mjeteve të mundshme për verifikimin e rezultateve nga secili rekomandim, të bazuara në studimin bazë.

GJETJET/REKOMANDIMET KRYESORE	AKTIVITETI QË DO TË ZBATOHET NË PROJEKT	VERIFIKIMI I REZULTATEVE
<i>Ngritja e kapaciteteve për zbulimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm</i>		
Të ngrihet kapaciteti i stafit shkollor	Aktiviteti 2.1. Programi për trajnim t'i përfshijë këto tema: bazat e radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimi; toleranca etnike; toleranca religjioze; identifikimi i gjuhës së urrejtjes; identifikimi i propagandës ekstremiste; zgjidhja e konflikteve; stereotipat dhe konfliktet dhe ndikimi i tyre dhe mendimi kritik	Numri i mësimdhënësve të trajnuar Raportet për trajnim Vlerësimi i rezultateve të trajnimit para dhe pas trajnimit
Zhvillimi i veglave për zbulimin dhe përkrahjen e stafit shkollor me të cilat identifikohen disa shenja potenciale të radikalizmit	Aktiviteti 2.2. Zhvillimi i protokolleve (dhe listave të kontrollit) për mësimdhënësit, psikologët dhe pedagogët për zbulimin e sjelljes së dhunshme, radikale dhe ekstremiste në klasë dhe menaxhimi i procesit shkollor	Protokollet dhe listat e kontrollit
Institucionalizimi i programit të mësimit për trajnim për E2P në programin e trajnimit të mësimdhënësve	(jo në aktivitetet e planifikuara) Integroni njohuritë dhe aftësitë për ekstremizëm dhe radikalizëm, por gjithashtu edhe për zgjidhjen e konflikteve, integrimin multietnik, tolerancën, devijimin, ndërmjetësimin, inteligjencën emocionale dhe bashkëjetesën në programin e mësimit për mësimdhënës.	Kërkesë për mendim nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit për programin e mësimit dhe veglat e trajnimit (duke marrë parasysh se periudha e projektit është e shkurtër) dhe në bazë të rezultateve të iniciohet një procedurë për përfshirjen e programit E2P për trajnim në programin mësimor për mësimdhënës.

GJETJET/REKOMANDIMET KRYESORE	AKTIVITETI QË DO TË ZBATOHET NË PROJEKT	VERIFIKIMI I REZULTATEVE
<i>Sistemi komunal për parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm</i>		
Rritja e njohurive dhe vetëdijes midis pjesëmarrësve në komunat për Strategjinë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	(jo në aktivitetet e planifikuara) Nëpërmjet organizimit të diskutimeve në tryezë të rrumbullakët për përforcimin e dialogut në nivel lokal që të bisedohet për nevojat dhe përgjigjet përkatëse të nevojave të komunës	Raport nga tryezat e rrumbullakëta dhe rekomandimet
Mekanizma më të mira të komunikimit për incidentet e dhunshme në shkolla	Aktiviteti 3.1. a. Të zhvillohet një model konkret komunikimi për sistemin e udhëzimit sipas kapacitetit të komunës	Modeli i udhëzimit
Përmirësimi i kapaciteteve të komunave për të pasur një rol aktiv në sistemin e reagimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm	Aktiviteti 3.3. Zhvillimi i një programi për trajnim që përfshin: bazat e ekstremizmit të dhunshëm, identifikimin e retorikës ekstremiste, tolerancën etnike/fetare, shenjat e zbulimit të radikalizmit	Programi për trajnim Numri i kreatorëve të trajnuar të politikave dhe palëve të tjera të prekura Raportet për trajnim Vlerësimi i rezultateve të trajnimit para dhe pas trajnimit
Zhvillimi i modelit të politikës për parandalimin e radikalizmit	Aktiviteti 3.1. Por duhet të përfshihet: ✓ Krijimi i një sistemi për mbledhjen e të dhënave dhe për ruajtjen e të dhënave në nivel lokal ✓ Të vendoset një lidhje midis organeve të nivelit lokal që punojnë në luftën/parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe Komitetit kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm ✓ Sigurimi i resurseve (financiare dhe arsimore) të cilat mund t'i përdorin mësimdhënësit ✓ Të kontrollohet nëse programi shkollor përfshin aktivitete të lidhura me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit	Modeli i politikës dhe Doracak



ANEKSI 1:

PYETËSORI PËR PERSONELIN SHKOLLOR

Të nderuar,

Pyetjet që vijojnë kanë për qëllim t'i vlerësojnë mendimet tuaja për tema të ndryshme të lidhura me çështjet e sigurisë në shkollë.

Një pjesë e pyetjeve janë me një zgjedhje të shumëfishtë, një pjesë kërkojnë që të jepen përgjigje në sferën përkatëse dhe një pjesë kërkojnë të plotësohen të dhëna/informacione. Nuk ka përgjigje të sakta ose të pasakta.

Ju rekomandojmë që të jepni përgjigje të ndershme. Përgjigjet tuaja do të na ndihmojnë në përgatitjen e një programi më të gjerë për trajnimin e stafit shkollor për të kuptuar më mirë gjendjen e sigurisë në shkollë, si dhe për zhvillimin e praktikave mësimore për menaxhimin e sfidave të caktuara të sigurisë.

Procesi i përfundimit të pyetësorit duhet të zgjasë rreth 20 minuta.

1

Sipas jush, cilat janë tre kërcënimet më të mëdha të sigurisë me të cilat ballafaqohet aktualisht Maqedonia e Veriut?

Cilat janë tre kërcënimet më të mëdha të sigurisë me të cilat ballafaqohet bota (globalisht)?

(Shënoni me **X** në fushat përkatëse)

	Në Maqedoninë e Veriut	Në botë (globalisht)
Korrupsioni		
Jostabiliteti politik		
Tensionet etnike		
Terrorizmi		
Krimi i organizuar		
Ekstremizmi i dhunshëm		
Radikalizmi religjioz		
Kriza me imigrantë – refugjatë		

Tjetër (ju lutemi shtoni)

2

Deri në cilën shkallë pajtoheni me këto pohime?

(Shënoni me **X** në fushat përkatëse)

	PAJTOHEM TËRËSISHT	PAJTOHEM PJESËRISHT	NUK PAJTOHEM	NUK PAJTOHEM TËRËSISHT	NUK E DI
Ekstremizmi është një kërcënim serioz për shoqërinë tonë					
Ai që ka mendime ideologjike-politike radikale bëhet i dhunshëm					
Ai që ka qëndrime ideologjike-politike radikale do të përpiqet t'ua bart ato të tjerëve					
Ai që ka mendime religjioze radikale bëhet i dhunshëm					
Ai që ka mendime religjioze radikale do të përpiqet t'ua bart ato të tjerëve					
Ai që angazhohet për padurim etnik bëhet i dhunshëm					
Ai që promovon mostolerancën etnike do të përpiqet t'ua bart atë të tjerëve					
Tek njerëzit e rinj, mendimet radikale janë vetëm një fazë e zhvillimit					

3

Sipas jush, sa janë të rëndësishme këto arsye që disa njerëz të rinj t'i pranojnë ideologjitë radikale që propagandojnë përdorimin e dhunës?

(Shënoni me **X** në fushat përkatëse)

	SHUMË E RËNDËSISHME	PJESËRISHT E RËNDËSISHME	E PARËNDËSISHME	NUK E DI
Ata janë të dhunshëm për nga natyra dhe kërkojnë mënyra për ta arsyetuar agresionin e tyre				
Ata besojnë se me përdorimin e dhunës do të çmohen/respektohen më shumë nga rrethina				
Ata mendojnë se janë viktimë të padrejtësisë së sistemit dhe po rebelohen për këtë shkak				
Ata kanë vështirësi të inkuadrohen në mjedis dhe kërkojnë grupe të cilat do t'i pranojnë				
Ata nuk mund të shohin një alternativë më të mirë (në aspektin e ideologjisë) në mjedisin në të cilin jetojnë				
Ata përpiqen të mbrohen nga “dominimi” i shumicës në komunitet duke e bërë veten më të ndryshëm se të tjerët				
Ata ndjehen të diskriminuar (për shembull, në bazë etnike, fetare, politike dhe sociale)				
Ata mendojnë se ai është një reagim përkatës ndaj padrejtësive të caktuara globale (konflikte të pazgjidhura, luftëra, represione të grupeve të caktuara etnike, fetare ose politike)				
Ata kërkojnë aventurë ose argëtim				
Ata janë kureshtarë për ideologjitë e ndryshme				
Ata janë në kërkim të identitetit të tyre/ndjenjës së përkatësisë				
Ata kërkojnë përgjigje/më shumë kuptim për religjionin dhe i gjejnë ato në grupe ekstremiste				
Tjetër (ju lutemi shtoni)				

4

Sipas mendimit tuaj, cilat vende/mjedise janë të përshatshme për indoktrinimin⁵ dhe radikalizmin e të rinjve?

(ju lutemi zgjidhni tre nga opsionet e poshtme)

- ☐ Shtëpia
- ☐ Shkolla
- ☐ Institucionet religjioze/shkollat fetare
- ☐ Interneti dhe mediat sociale
- ☐ Televizioni dhe radioja
- ☐ Grupet e moshatarëve
- ☐ Organizatat rinore
- ☐ Organizatat rinore partiake
- ☐ Fan-grupet e klubeve sportive
- ☐ Tjetër (ju lutemi shtoni) _____
- ☐ Nuk e di

5 Përkthimi i fjalës “indoctrination” në maqedonisht

5

A mendoni se në shkollën tuaj ka proces të radikalizmit të nxënësve në bazë fetare?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet e poshtme)

- ☐ Po, ka gjithmonë, me të njëjtin intensitet
- ☐ Po, ka gjithmonë, por rritet nga viti në vit
- ☐ Po, ai filloi gjatë viteve të kaluara
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

6

A mendoni se në shkollën tuaj ka qëndrime për jotolerancë etnike të nxënësve?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet e poshtme)

- ☐ Po, ka gjithmonë, me të njëjtin intensitet
- ☐ Po, ka gjithmonë, por rritet nga viti në vit
- ☐ Po, filloi gjatë viteve të kaluara
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

7

Sipas jush, cilat janë vendet më të përshatshme për zgjidhjen e problemeve të radikalizmit dhe indoktrinimit të nxënësve/të rinjve?

(ju lutemi zgjidhni tri nga opsionet e poshtme)

- ☐ Në shtëpi, me prindërit
- ☐ Në shkollë
- ☐ Në objektet fetare (vendet ku praktikohet religjioni)/shkollat fetare
- ☐ Përmes internetit dhe mediave sociale
- ☐ Përmes televizionit dhe radios
- ☐ Në grupet e moshatarëve
- ☐ Në organizatat rinore
- ☐ Në organizatat rinore politike partiake
- ☐ Në grupet e tifozëve të klubeve sportive
- ☐ Në OJQ-të (organizatat joqeveritare)
- ☐ Në institucionet e specializuara psikologjike shëndetësore
- ☐ Institucionet korrektuese
- ☐ Shërbimet e policisë dhe të sigurimit
- ☐ Tjetër (ju lutemi shtoni) _____

8

Nëse në shkollë zbatohen aktivitete të dedikuara për parandalimin e indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve, cila është metoda më e përshtatshme për realizimin e tyre?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet e poshtme)

- ☐ Në kuadër të programit të rregullt/të domosdoshëm mësimor. Në këto tema: _____
- ☐ Në kuadër të programit të rregullt/të domosdoshëm mësimor, gjatë orës së mësimi.
- ☐ Në kuadër të orëve plotësuese.
- ☐ Në kuadër të aktiviteteve jashtë mësimi.
- ☐ Tjetër *(ju lutemi shtoni)* _____
- ☐ Nuk e di

9

Sipas jush, sa duhet të jenë religjioni/ligjëratat religjioze pjesë e arsimit formal?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet e poshtme)

- ☐ Nuk duhet të jenë pjesë e programit mësimor
- ☐ Të gjitha religjionet më të mëdha duhet të ligjërohen në nivel themelor
- ☐ Të gjitha religjionet me të cilat lidhen nxënësit duhet të ligjërohen në nivel themelor
- ☐ Të gjitha religjionet duhet të mësohen në një nivel më të thellë
- ☐ Të gjitha religjionet me të cilat lidhen nxënësit duhet të ligjërohen në një nivel më të thellë
- ☐ Tjetër *(ju lutemi shtoni)* _____
- ☐ Nuk e di

10

Cilat nga këto tema duhet të jenë pjesë e programit mësimor të një shkolle të mesme me qëllim që të parandalohet radikalizmi i nxënësve?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet e poshtme)

- ☐ Bazat e radikalizmit, ekstremizmi i dhunshëm dhe parandalimi
- ☐ Toleranca etnike
- ☐ Toleranca religjioze
- ☐ Identifikimi i gjuhës së urrejtjes
- ☐ Identifikimi i propagandës ekstremiste
- ☐ Zgjidhja e konflikteve
- ☐ Stereotipat dhe konfliktet dhe ndikimi i tyre
- ☐ Mendimi kritik
- ☐ Asnjë nga të lartpërmendurat
- ☐ Tjetër *(ju lutemi shtoni)* _____
- ☐ Nuk e di

11

Në rast se vëreni shenja të indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve, kush mendoni se duhet të reagojë/të intervenojë

(sipas renditjes së prioritetit, shënoni me numra që lëvizin nga 1 deri 8, me ç'rast 1 e shënon faktorin e parë i cili duhet të intervenojë, ndërsa 8 shënon faktorin e fundit). Nëse mendoni se disa nga palët nuk duhet të intervenojnë fare, ju lutemi vini 0 në kuadrat.)

- ☐ Prindërit
- ☐ Mësimdhënësit
- ☐ Përkrahja e shkollës/stafi profesional
- ☐ Administrata komunale
- ☐ Bashkësitë fetare
- ☐ Shërbimet sociale
- ☐ Policia/forcat e sigurisë
- ☐ Organizatat civile/joqeveritare
- ☐ Tjetër

12

Shkruani tri fjalët që ju vijnë së pari në mend kur do ta dëgjoni fjalën “ekstremizëm”

1. _____
2. _____
3. _____

13

Shkruani tri fjalët që ju vijnë së pari në mend kur do ta dëgjoni fjalën “radikalizëm”

1. _____
2. _____
3. _____

14

Sipas jush, cilët nxënës/njerëz të rinj janë më të prirur të pranojnë ideologjitë radikale?

(mund të zgjidhni më shumë opsione)

- ☐ Nxënësit e familjeve me arsim më të ulët
- ☐ Nxënësit e familjeve më të varfra
- ☐ Nxënësit nga mjediset rurale
- ☐ Nxënësit e familjeve shumë religjioze
- ☐ Nxënësit e familjeve të cilat nuk praktikojnë religjionin shpesh

- ☐ Nxënësit e familjeve joreligjioze
- ☐ Nxënësit e familjeve me marrëdhënie të ndërprera midis prindërve
- ☐ Nxënësit e familjeve në të cilat janë të pranishme veset e këqija (alkoolizmi, keqpërdorimi i drogës, bixhozi, krimi etj.)
- ☐ Nxënësit të cilët jetojnë në mjedise monoetnike
- ☐ Nxënësit të cilët jetojnë në mjedise multietnike
- ☐ Nuk ka rregulla, secili është i prirur, pa marrë parasysh mjedisin
- ☐ Nuk e di

15

Sa i përket shkallës së dhunës midis nxënësve, ku do ta vendosnit shkollën tuaj?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet)

- ☐ E padhunshme
- ☐ Pjesërisht e dhunshme
- ☐ E dhunshme

16

Gjatë vitit 2017 dhe 2018, a ka pasur incidente të dhunshme në shkollë?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet)

- ☐ Po *(vazhdoni me pyetjen 17)*
- ☐ Jo *(vazhdoni me pyetjen 20)*
- ☐ Nuk kujtohem

17

A ishte dhuna:

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet)

- ☐ E motivuar nga religjioni
- ☐ E motivuat nga etnia
- ☐ E motivuar nga religjioni dhe etnia
- ☐ Tjetër _____

18

Cili është reagimi tipik ndaj këtyre incidenteve?

(zgjidhni të gjitha opsionet relevante)

- ☐ Prindërit e nxënësve thirren në shkollë
- ☐ Mësimdhënësi i klasës/mësimdhënësja e klasës disiplinon nxënësit
- ☐ Nxënësit shkojnë në këshillim te psikologu/pedagogu i shkollës
- ☐ Nxënësit marrin ulje të notës për shkak të sjelljes së tyre
- ☐ Nxënësit janë përjashtuar nga shkolla
- ☐ Incidenti raportohet në polici
- ☐ Incidenti raportohet te shërbimet sociale
- ☐ Nuk është bërë asgjë
- ☐ Tjetër _____
- ☐ Nuk e di

19

Nëse mendoni se dhuna është zbatuar për shkak të motiveve etnike ose religjioze, a duhet të përfshihen bashkësitë fetare?

(ju lutemi zgjidhni një nga opsionet)

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di



A duhet të ketë reagim (dhe cili lloj) nga ana e shkollës në rastin e paraqitjes së këtyre situatave hipotetike?

(ju lutemi shënoni me **X** në kuadratet përkatëse, mund të zgjidhni më shumë se një reagim për çdo situatë)

Situata	Nuk duhet të ketë reagim	Paralajmërim verbal	Ulje e notës për shkak të sjelljes	Përfshirje nga shkolla	Këshillim me personelin për përkrahje/stafin profesional	Tjetër (ju lutemi, shkruani)
Nxënësi refuzon të marrë pjesë në aktivitete të caktuara për shkak të motiveve fetare						
Nxënësi refuzon të mësojë përmbajtje të caktuara për shkak të motiveve religjioze						
Nxënësi fillon të vishen në mënyrë më konservative						
Nxënësi ndahet nga moshatarët (grupi me të cilin është shoqëruar)						
Nxënësi shpërndan fletushka/materiale propagandistike të cilat thërrasin për dhunë brenda ose jashtë shkollës						
Nxënësi shpërndan video materiale që thërrasin për dhunë në internet/mediat sociale						
Nxënësi sillet në mënyrë arrogante ndaj mësimeve dhe stafit shkollor						
Nxënësi mungon në mësim me qëllim që të takohet me një ekstremist ose grupe ekstremiste						
Nxënësi refuzon të kontaktojë/komunikojë me nxënësit të cilët i takojnë komunitetit të ndryshëm etnik dhe/ose fetar						
Nxënësi sulmon në mënyrë verbale nxënësit e komunitetit të ndryshëm etnik dhe/ose fetar						
Nxënësi sulmon fizikisht nxënësit të cilët i takojnë komunitetit të ndryshëm etnik dhe/ose fetar						

21

A keni komente shtesë lidhur me proceset e radikalizmit në shkollën tuaj?

22

A keni ndonjë përvojë personale me radikalizmin në shkollën tuaj të cilën do ta donit ta ndanit?

23

A keni marrë pjesë në pesë vitet e fundit në trajnime që lidhen me integrimin ndëretnik, zgjidhjen e konflikteve, parandalimin e dhunës dhe/ose sjelljen devijuese të nxënësve, njohjen me proceset e indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve ose trajnime të ngjashme?

☐ Po (vazhdoni me pyetjen 24)

☐ Jo (vazhdoni me pyetjen 27)

24

Ju lutemi shkruani trajnimet në të cilat keni marrë pjesë në 10 vitet e fundit, të cilat janë të lidhura me: integrimin ndëretnik, zgjidhjen e konflikteve, parandalimin e dhunës dhe/ose sjelljen devijuese të nxënësve, njohjen me proceset e indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve ose trajnime të ngjashme?

Tema	Organizuar nga:	Lloji i trajnimit (për shembull, ligjërata, punëtori, mentorim)

PËRVOJA ME TRAJNIMET E KALUARA

25

Ju lutemi shkruani tri gjëra të cilat ju pëlqyen/me të cilat u kënaqët gjatë trajnimeve paraprake?

- 1.
- 2.
- 3.

26

Çfarë do t'u propozonit organizatorëve që të evitojnë gjatë organizimit të trajnimeve?

NEVOJAT SHITESË PËR TRAJNIME

27

Cilat sfida të ardhshme i shikoni në kuadër të aktiviteteve tuaja të lidhura me punën: integrimi ndëretnik, zgjidhja e konflikteve, parandalimi i dhunës dhe/ose sjelljen devijuese të nxënësve, njohja me proceset e indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve?

28

Cilat lloje të trajnimeve ju nevojiten për t'i realizuar aktivitetet tuaja të lidhura me punën: integrimi ndëretnik, zgjidhja e konflikteve, parandalimi i dhunës dhe/ose sjelljen devijuese të nxënësve, njohja me proceset e indoktrinimit dhe radikalizmit të nxënësve?

JU LUTEMI PËRGJIGJUNI KËTYRE PYETJEVE DEMOGRAFIKE.

29

Gjinia

- ☐ femërore
☐ mashkullore

30

Vite (mosha)

- ☐ 22-34
☐ 35-49
☐ 50+

31

Cilit grup etnik i takoni?

- ☐ Maqedonas ☐ Serbë
☐ Shqiptarë ☐ Romë
☐ Turq ☐ Vllehë
☐ Të tjera (ju lutemi shtoni) _____

32

Arsimi i kryer (diplomë, fakultet):

33

Pozita në shkollë:

- ☐ Mësimdhënës (vazhdoni me pyetjen **34 A**)
☐ Anëtar i stafit tjetër (psikolog, pedagog, defektolog, sociolog) (vazhdoni me pyetjen **34 B**)

34

A (Nëse i anketuari është mësimdhënës) Lënda/lëndët të cilat i ligjëroni:

B (Nëse i anketuari është pjesë e personelit për përkrahje) Ju lutemi shkruani pozicionin tuaj:

- ☐ Psikolog ☐ Sociolog
☐ Pedagog ☐ Mësimdhënës për edukim special

32

Vitet e përvojës së punës në arsim:

33

A do të pranoni të intervistoheshit në lidhje me temat e përfshira në këtë pyetësor? *(Të dhënat tuaja personale do të mbeten anonime dhe nuk do të përfshihen në cilindo raport)*

- ☐ Po ☐ Jo

Nëse jeni përgjigjur me Po, Ju lutemi lini numrin e telefonit tuaj dhe/ose postën tuaj elektronike për kontakt të mëtejshëm

JU FALEMINDERIT!

ANEKSI 2:: EKZEMPLARËT E HULUMTIMIT

Qyteti	Shkolla	Numri i hulumtimeve
Shkup	SHMQSH “Arseni Jovkov”	25
Shkup	SHMQSH “ 8 Shtatori”	25
Shkup	SHMQSH “Cvetan Dimov”	25
Shkup	SHMQSH “Pançe Karagjozov”	25
Shkup	SHMQSH “Boro Petrushevski”	25
Shkup	SHMQSH “Zef Lush Marku”	25
Shkup	SHMQSH “Marija Kiri-Skllodovska”	25
Tetovë	SHM “Gjoce Stojčevski”	25
Tetovë	SHM “Kiril Pejčinović”	25
Tetovë	SHMPK “Mosha Pijade”	25
Tetovë	SHMKM “Nikolla Shtejn”	25
Tetovë	SHMEK “8 Shtatori”	25
Tetovë	SHMM “Todor Skalovski – Tetoec”	25

Qyteti	Shkolla	Numri i hulumtimeve
Kumanovë	Gjimnazi “Goce Dellçev”	25
Kumanovë	SHM “Goce Dellçev”	25
Kumanovë	SHM “Kiro Burnaz”	25
Kumanovë	SHMKT “Nace Bugjoni”	25
Kumanovë	SHMK “Pero Nakov”	25
Gostivar	SHMEK “Gostivar”	25
Gostivar	SHMKT “Zllate Malakoski”	25
Gostivar	Gjimnazi “Pançe Poposki”	25

**GJITHSEJ TË ANKETUAR
525**

